



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i drejtësisë

Правен факултет

Faculty of law

STUDIMET POSTDIPLOMIKE – CIKLI DYTË

DREJTIMI CIVIL

TEMA:

“E DREJTA E FËMIJËS PËR TË NJOHUR PREJARDHJEN E TIJ, KONTRADIKTAT LIGJORE NË
LEGJISLACIONIN POZITIV TË RMV-SË ME KONVENTËN E OKB-SË PËR TË DREJTAT E FËMIJËS DHE
KONVENTËN EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT”

Mentor:

Doc. Dr. Arta Selmani – Bakiu

Kandidatja:

Arbenita Iljazi

Tetovë, 2021

Përmbajtja

Abstrakt.....	4
Hyrje.....	5
Qëllimet e hulumtimit.....	8
Hipotezat.....	9
Metodologjia e hulumtimit.....	10
Kapitulli I	11
Adoptimi.....	11
1.1 Nocioni dhe llojet e Adoptimit	11
1.1.2 Llojet e adoptimit.....	12
Adoptimi i plotë	13
Adoptimi jo i plotë	13
1.2. Kushtet dhe procedura e adoptimit	14
1.2.1 Kushtet për adoptim	14
1.2.2 Procedura për adoptim.....	15
1.3 Adoptimi në të drejtën komperative	17
1.3.1 Adoptimi në Shqipëri	18
1.3.2 Adoptimi në Kosovë	19
1.3.3 Adoptimi ne Francë.....	20
1.3.4 Adoptimi në Zvicër	21
1.3.5 Adoptimi në Gjermani.....	22
Kapitulli II	24
Bioetika dhe riprodhimi artificial	24
2.1 Bioetika dhe zhvillimi i saj.....	24
2.2 Riprodhimi artificial dhe çështjet etike	25
2.2.1 Prejardhja e gametëve.....	27
2.2.2 Statusi i fëmijëve.....	27
2.2.3 Statusi i prindërve	28
2.3 Metodatat e Riprodhimit Artificial. Riprodhimi Homolog dhe Heterolog	31
2.3.1 Infertiliteti dhe shkaqet e tij	31
2.3.2 Teknikat e riprodhimit artificial	32
Teknikat e dhurimit të gametëve.....	35

Dhurimi i embrionit.....	36
Kapitulli i III.....	36
3.1. Njohja e prejardhjes - një element thelbësor i identitetit personal.....	36
3.2. E drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij / saj e garantuar me dokumentet ndërkombëtare	37
3.3. Rishikimi krahasues i të drejtës së fëmijës për të njohur origjinën e tij ose të saj 40	
3.4. Kuadri ligjor dhe kontradiktat në legjislacionin maqedonas lidhur me të drejtën për të njohur origjinën	43
3.5 Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen e të drejtës së identitetit personal	44
Kapitulli IV	46
4.1. E drejta e fëmijëve për të njohur prindërit e tyre biologjik.....	46
4.1.1 E drejta negative për të njohur origjinën e dikujt / e drejta pozitive për të njohur origjinën e dikujt	48
4.2 E drejta e anonimitetit e prindërve biologjikë dhe donatorëve	49
Rekomandimet.....	51
Përfundimi.....	53
Literatura.....	55

Abstrakt

Arsyetimi i të drejtës së fëmijës për të njohur prejardhjen e tij biologjike si dhe interesi më i lartë i fëmijës ka tërhequr shumë vëmendje vitet e fundit. Ky punim shkon një hap më tej dhe vlerëson zbatimin e kësaj të drejte në praktikë me parimet e saj udhëzuese. Fillon duke ritheksuar atë me të cilën përbëhet e drejta si dhe çfarë interesash mbrohen nga dokumentet ndërkombëtare. Më pas zbulon konfliktet e të drejtave që qëndrojnë në zemër të zbatimit të së drejtës për të njohur dhe për të shpjeguar kompleksitetin e saj. Duke pasur parasysh interesat konkurruese, punimi argumenton se asnjë nga këto interesa dhe të drejta duhet të konsiderohen si absolute dhe sugjeron mënyra me të cilat mund të ekulibrohen njëra me tjetrën. Duke u nisur nga kjo në këtë punim do të analizohen qëndrimet e legjislacionit vendor si dhe dokumentet ndërkombëtare siç janë Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijëve dhe Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut. Duke u bazuar në evolucionin e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut si dhe praktikën gjyqësore do të analizojmë rastet konkrete si dhe kontradiktat në mes legjislacionit pozitiv të RMV-së më konkretisht Ligji për insiminim të ndihmuar biomedicinal të vitit 2008 dhe ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji të vitit 2014 në lidhje me anonimitetin e donatorve si dhe mospajtimin e Ligjit për familje me dokumentet ndërkombëtare në garantimin e të drejtës së fëmijës. Nga mospërputhja e legjislacionit të maqedonisë me dokumentet ndërkombëtare si dhe zbrastirat juridike në këtë punim do të jepen propozime dhe rekomandime që në Ligjin për Familje të implementohet parimi interesi më i lartë i fëmijës, përkatsisht të njihet e drejta e fëmijës për të njohur prindërit e tij biologjik.

Fjalët kyçe: e drejta e identiteti, prindërit biologjik, adoptimi, metodat artificiale, anonimiteti i donatorve.

Hyrje

Pyetja nëse një fëmijë ka të drejtë që të njohë prejardhjen e tij biologjike është bërë një nga çështjet më të vështira gjatë 20 viteve të fundit. Çdo fëmijë ka të drejtën e jetës, dhe i njeiti ka të drejtën që të kenë një marrëdhënie me të prindërit biologjik. Mirëpo kjo është bërë e vështirë si pasojë e ndryshimit të konceptit të familjes tradicionale të kohëve të vjetra, e cila në kohën e sotme mund të krijohet në mënyra të ndryshme.

Një nga mënyrat e formimit të familjes është adoptimi, i cili është i njohur që kohë më parë ku fëmijët e adoptuar fitojnë të gjitha të drejtat e njejtat si fëmijët biologjik mirëpo nga ana tjetër humbin të drejtën për të njohur prindërit e tyre, edhe pse kjo e drejtë ju garantohet me Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve, kurse mënyra më e ndërlikuar për formimin e familjes është përdorimi i metodave artificiale të reproduktimit më saktësisht insiminimi artificial dhe fekondimi invitro, të cilët kohën e fundit në shoqërinë tonë janë bërë një “trend i madh” për arsye se situatat jetësore sjellin probleme nga më të ndryshmet që për pasojë çiftet e martuara kanë pamundësinë që në mënyrë natyrore të lindin fëmijë, kështu që ata vendosin të shfrytëzojnë njëri nga këto metoda për lindjen e fëmijës. (Ilazi, 2019) Të dy këto veprime plotësojnë mungesën biologjike për të mos pasur fëmijë, mirëpo flasin për shkëlqjen e të drejtës së fëmijëve për të njohur prejardhjen e tyre, e cila ju garantohet me dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare siç janë Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës, Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore si dhe Konventa evropiane për adoptim (Shala, 2013).

Sipas Ligjit për familjen të RMV-së, pas themelimit të adoptimit të plotë, emrat e adoptuesve shënohen në librin amë të të lindurve, dhe ata llogariten si prindër të të adoptuarit që nga momenti i lindjes së tij. Në pajtueshmëri me këtë, të dhënat lidhur me prindërit biologjik mbahen si fshehtësi zyrtare. Në rastet kur marrëdhënia prindërore është themeluar me anë të adoptimit, vërtetimi ose mohimi i atësisë/amësisë nuk është i lejuar. Nga kjo aludon fakti se fëmija i adoptuar shkapet çdo marrëdhënie familjare por edhe juridike me prindërit biologjikë, kurse të drejtën e tij për përkujdesje prindërore e plotësojnë adoptuesit. Nga njëra anë, për një siguri dhe stabilitet familjar me adoptuesit, ky veprim edhe arsyetohet. (Selmani, PortAlb, 2021) Mirëpo, kur pjekuria e tij/saj psiko-fizike është e arsyeshme dhe stabile, dhe nëse fëmija shpreh

interesim, nuk duhet t'i kufizohen informatat të cilat do t'i ndihmonin të kuptonte të vërtetën rreth prejardhjes së tij/saj familjare. (Selmani, PortAlb, 2021)

Çështja e identitetit gjenetik, vjen në shprehje në rastet kur fëmija është i zënë me metoda artificiale të reproduktimit, veçanërisht kur fertilizimi i tij është bërë me materiale gjenetike të donuara. Absurditeti në legjislacionin familjar dhe biomedicinal të RMV-së qëndron pikërisht në fshehjen e të vërtetës së prejardhjes edhe në këto situata e cila ngre çështjen e të drejtave ose interesave të fëmijëve që të njohin dhe të edukohen nga prindërit ose të afërmit e tyre biologjikë.

Duke u nisur nga ky fakt në këtë punim do të shqyrtohen të gjitha çështjet e lartpërmendura ku do të analizojmë se cila e drejtë duhet të respektohet më shumë E drejta e prindërve për të ngelur anonim? apo E drejta e fëmijëve për të njohur prindërit e tyre biologjik?. Gjithashtu do të analizojmë metodat artificiale të lindjes së fëmijëve në të cilat një rëndësi të veçantë do ti kushtojmë insiminimit artificial dhe fekondimi invitro në rastet kur ngjizja e fëmijës bëhet me material gjenetik të donuar, të cilat në RMV rregullohen me Ligjin për insiminim të ndihmuar biomedicinal të vitit 2008 dhe ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji të vitit 2014, për të cilat në punim do të jepen detajet lidhur me procedurën e përgjithshme të insiminimit artificial dhe fekondimi invitro, në bazë të të cilave lindin pyetjet se cila e drejtë duhet të respektohet më shumë E drejta e anonimitetit të donatorit?, apo E drejta e fëmijës për të njohur prejardhjen e tyre biologjike?

Në këtë punim rëndësi të veçantë do tju kushtohet edhe rasteve konkrete nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në lidhje me pyetjet e lartpërmendura, si dhe do të analizojmë rregullimin e kësaj të drejte në dy dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare Konventa Evropiane për të drejtat e fëmijëve dhe Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Duke parë në Ligjin për familje dhe Ligjin për insiminim të ndihmuar biomedicinal të vitit 2008 dhe ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji të vitit 2014, mund të vërehet një konflikt në mes legjislacionit tonë dhe dokumenteve ndërkombëtare siç janë Konventa evropiane për të drejtat e fëmijëve dhe Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut, për të cilat gjatë punimit do të flasim më detajisht. Në këtë punim do të trajtohen edhe zbrastirat juridike në legjislacionin tone, ku rëndësi e veçantë do ti kushtohet parimit "Interesi më i lartë i fëmijës"

duke respektuar të drejtën e fëmijëve për të njohur prejardhjen e tyre biologjike, ku në Kapitullin e I-rë do të flasim për adoptimin, llojet e adoptimit, procedura e përgjithshme për adoptim, Kapitullin e II-të do të flasim për bioetiken, metodat artificiale për lindjen e fëmijëve më konkretisht do të flasim për insiminimin artificial dhe fekondimin invitro, llojet, kushtet si dhe për procedurat e përgjithshme të tyre, Kapitullin e III-të do të shqyrtohen kontraditat në mes legjislacionit vendor dhe dokumentet nderkombetare si dhe rastet konkrete në praktikën gjyqësore, si dhe do të trajtohen të drejtat e prindëve dhe donatorëve për anonimitetin e tyre si dhe e drejta e fëmijëve për të njohur prejardhjen e tyre biologjike.

Në pjesën e fundit të punimit do të paraqiten rekomandimet dhe konkluzionet e nxjerra të asaj që është hulumtuar, si dhe do të jepen propozime dhe rekomandime që në Ligjin për Familje të implementohet parimi “interesi më i lartë i fëmijës”, përkatsishtë të njihet e drejta e fëmijës për të njohur prindërit e tij biologjik.

Qëllimet e hulumtimit

Duke marrë parasysh interesin e fëmijëve për të njohur prindërit e tyre në këtë punim do të pasqyrohen konfliktet ligjore që egzistojnë dhe do të jepet pasqyrim për ndryshim plotësim të legjislacionit tonë në lidhje me temën e lartpërmendur. Gjithashtu për të njejtën do të pasqyrohen informacionet të marra nga shoqëria jonë, nga organe kompetente të cilat merren me rregullimin e adoptimit, teknikat e riprodhimit artificial si dhe nga vetë fëmijët të cilët janë në njohuri për statusin e tyre.

Gjithashtu do të jepen të dhëna për hulumtimet e bëra në praktikën juridike vendore, si dhe të huaj, duke analizuar raste të paraqitura para Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut. Përmes një kërkimi të detajuar teorik dhe praktik, punimi do të jep një pasqyrë të detajuar për rregullimin e adoptimit dhe metodave artificiale për lindjen e fëmijëve duke i kushtuar një rëndësi të madhe të drejtës së fëmijëve për të njohur prejardhjen e tyre biologjike.

Hipotezat

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të respektohet parimi “Interesi më i lartë i fëmijëve” gjegjësisht e drejta e fëmijëve për të njohur prejardhjen e tyre biologjike. Duke marrë parasysh faktin se legjislacioni jonë reptësisht e ndalon që fëmijët të marrin informacion për prindërit e tyre biologjik ose për personin i cili ka kontribuar në lindjen e tij me materialin gjenetik të donuar, në këtë punim do të parashtroj dy hipoteza të rëndësishme, zgjidhja e të cilave e përbën edhe qëllimin e këtij punimi:

1. Anonimiteti i prinderve biologjik? Anonimiteti i donatorëve?
2. E drejta e fëmijëve për të njohur prejardhjen?

Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e cila do të përdoret për hulumtimin e këtij bazohet në një studim të thellë dhe të kujdesshëm. Hulumtimi mbështetet në të dhëna, burime të ndryshme si dhe udhëzime dhe këshilla nga ana e mentores të cilat kanë rëndësi të madhe në përpilimin e këtij punimi.

Metodat të cilat do të përdoren në këtë punim janë:

- **Metoda e analizës** - me anë të së cilës do të analizojmë në mënyrë të detajuar në lidhje me institutin e adoptimit, llojet, kushtet e adoptimit, procedurën në legjislacionin tonë si dhe do të analizojmë adoptimin në disa shtete të Evropës. Gjithashtu do të analizohen teknikat riprodhuese artificiale, kontraditat në mes legjislacionit tonë dhe dokumenteve ndërkombëtare si dhe praktika gjyqsore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.
- **Metoda krahasuese** – me anë të cilës do të bëjmë krahasim e legjislacionit pozitiv të Republikës së Maqedonisë së Veriut me dokumentet ndërkombëtare si Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës dhe Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.
- **Metoda statistikore** – me anë të së cilës do të kemi një pasqyrë më të qartë për situatën e fëmijëve pa mbrojtje prindërore dhe interesin e tyre për të njohur prindërit e tyre biologjik.
- **Metoda e anketimit** – me anë të së cilës do të mledhim të dhëna të nevojshme ne atë se çfarë mendojnë personat e kategorizuar, organet kompetente dhe fëmijët të cilët njohin statusin e tyre.

Për mbledhjen e të dhënave do të përdoren:

- Grumbullimi i librave dhe materialeve të nevojshme për përpilimin e punimit
- Marrja e të dhënave të nevojshme nga internet

Kapitulli I

Adoptimi

1.1 Nocioni dhe llojet e Adoptimit

Adoptimi është i vjetër sa është e vjetër shoqëria. Edhe në kohën më të vjetër, kur njerëzit kanë jetuar në fise, para formimit të shtetit dhe drejtësisë, ka qenë zakon që i burgosur ose i huaji të pranohet në fis që i njëjti të forcohet në anën luftarake dhe punëtore, ose që të shmanget hakmarrja në fis është pranuar anëtar i fisit të viktimës, etj. Me paraqitjen e shteteve, adoptimi u bë i njohur tek Egjiptianët, Grekët dhe Romakët e vjetër. Megjithatë, si institut juridik, adoptimi më së shumti është i njohur në të drejtën romake, veçanërisht në kodifikimin e tij. Në feudalizëm adoptimi pothuajse u zhduk që të lulëzojë diku në shoqërinë borgjeze, për vazhdimin e rrënjës së familjes të personit i cili nuk ka familje personale. Në të gjitha shoqëritë demokratike bashkëkohore dhe të civilizuara, adoptimi nuk ekziston për shkak të vazhdimin të pasardhësve të familjes, por për shkak të kujdesit dhe mbrojtjes të fëmijëve të mitur të cilët kanë mbetur pa kujdesin e prindërve. (Silavkoski, 2013, f. 53)

Institucioni i adoptimit paraqet institucion juridiko-shoqëror, me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror, me të cilën në mes adoptuesit dhe të adoptuarit krijohet një marrëdhënje prindërore e cila është identike me marrëdhënjen prindërore në mes fëmijës dhe prindërve të tij biologjikë. Adoptimi është marrëdhënje e cila krijohet në mënyrë artificiale me akt ligjor. (Silanoska-Kostadinovska, 2013, f. 256)

Institucioni i adoptimit ka egzistuar që në kohërat para se të egzistonte shteti dhe e drejta. Në atë kohë qëllimet kryesore të adoptimit kanë qenë ruajtja e origjinës, ruajtja e pasurisë në rrethin familjar, vazhdimi i emri të familjes, traditat dhe kulti i adoptuesit të cilët kanë adoptuar fëmijë të moshës madhore (Podvorica, 2006, f. 203), kurse me kalimin e kohës qëllimet e adoptimit kanë ndryshuar, diçka e tillë mund të vërehet që nga Ligjit për Familje (LF) ku në nenin 97 thekson se “Adoptimi mund të themelohet vetëm nëse është në pajtim me interesin më të lartë të fëmijëve” (Ligji për familje, 2013). Duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve kuptohet që me adoptim përveç anës materiale, fëmijët të cilëve iu kanë vdekur prindërit ose fëmijët e braktisur nga prindërit e tyre biologjik, kanë nevojë që tju jepet

dashuria prindërore, ngrohtësia familjare si dhe të krijohen mundësi materiale që të ketë një të ardhme më të mirë. (Micković R. , 2015).

Mirëpo duhet theksuar që me anë të adoptimit nuk përmbushet vetëm interesi i fëmijëve, gjithashtu përmbushet interesi i të rriturve apo adoptuesit nga ana emocionale me qëllim të përmbushjes së nevojave të tyre për tu bërë prindër si dhe të kenë dikë që të kujdeset për ta në kohën kur do të kenë nevojë.

Adoptimi krijon marrëdhënie intime dhe të rëndësishme për fëmijën që janë të paçmueshme në rritjen e tij, dhe që sigurisht përfaqësojnë një nga interesat e tij më të mirë. Prandaj, marrëdhëniet intime që ne mbajmë dhe zhvillojmë gjatë ekzistencës sonë kontribuojnë në krijimin e identitetit tonë dhe përgjithësisht forcojnë përkatësinë tonë në ekip, gjë që është shumë e rëndësishme për familjen. Ato janë gjithashtu një burim i lumturisë, përparimit dhe forcës sonë. (Silanoska-Kostadinovska, 2013, f. 276)

Problemi i kujdesit për fëmijët pa mbrojtje prindërore është një pyetje e vazhdueshme që kërkon përgjigje të përhershme në lidhje me ligjvënësin e çdo komuniteti dhe në çdo sistem ligjor. E drejta familjare duhet të garantojë të njëjtat të drejta dhe qëndrueshmëri të marrëdhënies juridike prindërore për të gjitha kategoritë e fëmijëve, pavarësisht nga origjina. Duhet të kemi parasysh se kjo garanci, si dhe çdo garanci tjetër që shkon për të mbrojtur interesat më të mira të fëmijës, nga pikëpamja ligjore, është më e fortë dhe më e mirë për sa është më e ndërkombëtarizuar dhe e pranuar përgjithësisht.

1.1.2 Llojet e adoptimit

Në teorinë dhe praktikën gjyqësore në varësi të marrëdhënjeve që krijohen në mes adoptuesit dhe të adoptuarit si dhe në qëndrueshmërinë e tyre egzistojnë dy lloje të adoptimit:

1. adoptimi i plotë
2. adoptimi jo i plotë.

Nën ndikimin e Konventës Evropiane për të drejtat e fëmijëve (KEDF), një numër i madh i shteteve kanë sjell reforma në legjislacionet familjare dhe si lloj të adoptimit e parashikojnë vetëm adoptimin e plotë. Përkundër kësaj tendence të pranishme në shoqërinë moderne, e drejta jonë familjare në Ligjin për familje nuk ka sjellur asnjë reformë dhe vazhdon të ketë të dy llojet e adoptimit (i plotë dhe jo i plotë). (Micković R. , 2015, f. 251)

Adoptimi i plotë

Adoptimi i plotë themelohet kur në mes adoptuesit vendosen marrëdhënje të njejta sikurse mes prindërve natyrorë dhe fëmijëve, por edhe me persona të tjerë si në gjini gjaku. (Podvorica, 2006, f. 204) Adoptimi i plotë është marrëdhënje e pashkëpuetshme dhe krijohet me pëlqimin paraprak të prindërve, kujdestarit si dhe të vetë fëmijës nëse është më i madh se 12 vjet, dhe në aspektin formal ndërpriten të gjitha marrëdhënjet në mes fëmijëve dhe prindërve të tyre biologjikë, dhe fiton të drejta dhe detyrime të plota sikurse të kishte lindur prej vetë adoptuesit. (Podvorica, 2006, f. 204) Me adoptim të plotë fëmijët humbin të drejtat dhe detyrimet ndaj të afërmeve biologjikë: të drejtat familjare, trashëgimore dhe të drejtat tjera. Mirëpo në të njejtën kohë, këto të drejta dhe detyrime i fitojn ndaj adoptuesit dhe të afërmeve të tij biologjikë, për shkak se marrëdhënjet që krijohen nga adoptimi i plotë është i përhershëm, dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet janë identike me ato që egzistojnë në mes familjes biologjike. (Podvorica, 2006, f. 204)

Adoptimi jo i plotë

Me adoptimin jo të plotë në mes adoptuesit dhe të adoptuarit krijohet marrëdhënje të cilat egzistojnë në mes prindërve dhe fëmijëve, mirëpo janë të mundshme kufizimet në pikëpamje të të drejtave, veçanërisht me mbiemrin dhe të drejtën trashëgimore. (Micković R. , 2015, f. 252). Tek adoptimi jo i plotë fëmijët paraqesin subjekt të marrëdhëneve të reja prindërore, megjithatë edhe më tej mbetet antar i familjes së vet biologjike. Si rezultat i kësaj i adoptuari edhe më tej ka të drejta dhe detyrime me familjen e tij biologjike, duke përfshirë edhe të drejtën trashëgimore. Ndryshe nga adoptimi i plotë, në rast të adoptimit jo të plotë, të drejtat e trashëguara të të adoptuarit ndaj adoptuesit mund të kufizohen ose të përfundohen plotësisht, nëse në momentin e adoptimit, adoptuesi ka fëmijët e tij. Adoptimi jo i plotë nuk është i përhershëm, marrëdhënja në mes adoptuesit dhe të adoptuarit është e shkëputshme, dhe pas shkëputjes fëmija u kthehet prindërve të tyre biologjikë. (Podvorica, 2006, f. 205).

1.2. Kushtet dhe procedura e adoptimit

1.2.1 Kushtet për adoptim

Sa u përket kushteve për themelimin e adoptimit, që në fakt edhe janë nën kornizën e masave juridike për vendosjen e një fëmije në adoptim, LF përmban kushtet që një fëmijë duhet ti plotësojë që të adoptohet, kushtet që një person duhet t'i plotësojë për të adoptuar fëmijë si dhe kushtet formale dhe materiale të organit kompetent për zhvillimin e procedurës për themelimin e adoptimit. (Selmani, Adoptimi mbrojtja juridike për fëmijët pa prind dhe pa përkujdesje prindërore sipas legjislacionit të RM-së, 2008, f. 5)

Me anë të adoptimit realizohen qëllimet dhe plotësohen nevojat e fëmijës, shoqërisë, adoptuesve si dhe prindërve biologjik të cilët nuk kanë kushte materiale për përkujdesjen e fëmijës. Mirëpo, si qëllim primar për adoptim është respektimi i Interesit të fëmijës. (Selmani, Adoptimi-mbrojtje juridike për fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore sipas legjislacionit të RM-së, 2008, f. 7) Tani parashtrohet pyetja, ky interes është i natyrës materiale apo shpirtërore? Nëse merren parasysh kushtet në të cilët jetojmë dhe standardin ekonomik në shtetin tonë, shumica e fëmijëve do të kishin në prioritet realizimin e interesit material dhe sigurimin e jetës së tyre, mirëpo pas sigurimit material në të njëjtin nivel është edhe plotësimi i natyrës shpirtërore dhe zëvendësimi i familjes së origjinës. (Selmani, Adoptimi-mbrojtje juridike për fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore sipas legjislacionit të RM-së, 2008, f. 7) Në shtetin tonë në të shumtën e rasteve, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike me të cilën përballen çiftet e reja, janë të detyruar që pa dëshirën e tyre t'i lënë fëmijët nëpër jetimore, e që është edhe më e prekshme braktisja në rrugë e foshnjës së posa lindur nga vajzat e reja të cilat nuk kanë rrugëdalje tjetër, në këto situata shteti duhet të ndërmerr masa adekuate dhe speciale për parandalimin e këtyre rasteve. (Selmani, Adoptimi-mbrojtje juridike për fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore sipas legjislacionit të RM-së, 2008, f. 7)

Sipas LF, prind adoptues mund të jetë personi i cili është i aftë ligjërisht, i cili ka cilësi personale për ushtrim të suksesshëm të të drejtave prindërore dhe nuk është më i vjetër se 45 vjet. Birësuesi duhet të jetë të paktën 18 vjet më i vjetër se birësuesi. Sidoqoftë, si përjashtim, një person më i vjetër se 45 vjeç mund të aplikojë gjithashtu si prind adoptues, por diferenca e moshës midis adoptuesit dhe të adoptuarit nuk duhet të kalojë 45 vjet. (Silanoska-

Kostadinovska, 2013) Bashkëshortët mund të aplikojnë për birësim nëse njëri prej tyre nuk e kalon kufirin e sipërm të moshës. (Ligji për familje, 2013)

Kurse nuk do ti jepet në adoptimi fëmija personit të cilit:

- a) i është marrë apo kufizuar e drejta prindërore, si dhe personit të cilit i është shqiptuar dënimi për kryerje të veprës penale me dënim burg efektiv me kohëzgjatje mbi gjashtë (6) muaj,
- b) i është kufizuar apo marrë aftësia e veprimit, (Ligji për familje, 2013)
- c) për të cilin ekziston dyshim i bazuar se pozitën e adoptuesit do ta shfrytëzoj në dëm të të adoptuarit,
- ç) i cili ka sëmundje shpirtërore apo ka pengesa në zhvillimin intelektual, si dhe personi i cili vuan nga sëmundja e cila do të mund ta sillte në rrezik shëndetin dhe jetën e të adoptuarit,
- d) pengesa fizike e të cilit është e asaj shkalle për të cilën në mënyrë të arsyeshme mund të dyshohet në mundësinë e ushtrimit të kujdesin ndaj të adoptuarit,
- dh) i cili është më i vjetër se 45 vjet, (Ligji për familje, 2013)
- e) i cili është i varur nga droga apo substanca psikotropike apo alkooli,
- ë) i cili ka sëmundje të rëndë kronike apo lëngon nga sëmundja jo e shërueshme ngjitëse dhe
- f) nëse mendimi i ekipit profesional i qendrës për punë sociale është negativ lidhur me mundësinë që ato persona të jenë prindër. (Ligji për familje, 2013).

1.2.2 Procedura për adoptim

Procedura për adoptimin e një fëmije fillon me paraqitjen e një kërkesë për adoptim në Komisionin për vendosjen e birësimin në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale. Dokumentet e mëposhtme duhet t'i bashkangjiten kërkesës: certifikata e shtetësisë; certifikatën e lindjes certifikatën e martesës; certifikatë mjekësore për shëndetin dhe aftësinë psiko-fizike për të adoptuar një fëmijë; vërtetim se nuk u privohen të drejtat prindërore; vërtetim se nuk janë dënuar; vërtetim se kapaciteti i tyre i biznesit nuk është revokuar; vërtetim për gjendjen materiale; dëshmi e pronësisë së një apartamenti; vërtetim për arsimin e përfunduar; dhe dokument për të ardhurat mujore dhe të ardhurat e tjera që disponojnë. (Micković R. , 2015, f. 258).

Të gjitha dokumentet duhet t'u referohen të dy bashkëshortëve dhe duhet të paraqiten në origjinal ose në një fotokopje të notarizuar, vlefshmëria e të cilave është një vit.

Sipas Ligjit për Familjen, adoptuesi si rregull mund të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë Veriore, dhe si përjashtim, personi i cili është shtetas i huaj gjithashtu mund të aplikojë si prind adoptues. Adoptimi nga një shtetas i huaj mund të vendoset vetëm me pëlqimin e Komisionit për krijimin e adoptimit në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, dhe pëlqimi do të lëshohet vetëm nëse fëmija nuk mund të adoptohet në territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore. (Adoptimi i fëmijës, 2021)

Kur aplikanti është një person i cili është një **shtetas i huaj ose një shtetas maqedonas që jeton dhe punon jashtë vendit**, përveç dokumenteve të mësipërme që duhet të paraqiten në origjinal ose një fotokopje e vërtetuar nga një noter dhe një përkthim i vërtetuar nga gjykata i dokumenteve në maqedonisht (Adoptimi i fëmijës, 2021), ai duhet të paraqesë dhe:

- fragmente nga ligji i vendit të prindërve adoptues në lidhje me adoptimin dhe informacione dhe prova të tjera për të siguruar kushte të barabarta ose më të mira jetese dhe zhvillimin e fëmijës, dhe

- raport nga shërbimi i duhur shoqëror mbi aftësinë, pranueshmërinë dhe motivet e adoptimit, origjinën e tyre, historinë familjare dhe mjekësore, mjedisin shoqëror, arsyet e adoptimit, mundësinë e adoptimit ndërkombëtar dhe karakteristikat e fëmijëve për të cilën do të ishin në gjendje të kujdeseshin. (Adoptimi i fëmijës, 2021).

Komisioni për krijimin e adoptimit pas shqyrtimit të dokumenteve paraqet një kopje të çështjes në qendrën për punë sociale sipas vendbanimit të kërkuarit. Në katër muajt e ardhshëm, Qendra për Punë Sociale do të zhvillojë një procedurë për monitorimin e prindërve të mundshëm adoptues, në mënyrë që të vlerësojë të drejtën e tyre dhe motivin për birësim.

Pas përfundimit të procedurës së monitorimit, qendra për punë sociale brenda 10 ditëve Komisionit për krijimin e birësimit, paraqet një propozim për regjistrim në Regjistrin e prindërve të mundshëm adoptues. Komisioni për vendosjen e birësimit brenda 30 ditëve merr vendim për regjistrim në Regjistrin e prindërve të mundshëm adoptues, i cili e paraqet atë në qendrën për punë sociale dhe informon prindërit adoptues se janë regjistruar në regjistër. (Micković R. , 2015, f. 259)

Sipas Ligjit të Familjes, zgjedhja e një prindi adoptues për një fëmijë të veçantë bëhet në mënyrë elektronike. Kriteret më të hollësishme dhe mënyra e zgjedhjes së prindit birësues në mënyrë elektronike përcaktohet në Rregulloren për kriteret më të afërta dhe mënyrën e

zgjedhjes së prindit birësues në mënyrë elektronike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 60/12).

Rregullorja përcakton kriteret dhe pikat vijuese:

- kushti shëndetësor-3 pikë;
- statusi psikosocial - 35 pikë;
- kushtet materiale-18 pikë;
- kushtet e banimit-18 pikë;
- koha e pritjes-10 pikë;
- shkalla e arsimit-3 pikë;
- statusi martesor-13 pikë dhe
- shtetësia - sipas këtij kriteri nuk merren pikë, por gjatë zgjedhjes së prindit birësues në mënyrë elektronike, përparësi u jepet qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Numri maksimal i pikëve që mund të merren duke përmbushur të gjitha kriteret është 100 pikë. (www.mtsp.gov.mk, 2020)

Komisioni për krijimin e adoptimit nga inspektimi i dokumenteve dhe të dhënave të futura në programin elektronik, zgjedh adoptuesin më të përshtatshëm nga 3 adoptuesit e parë të mundshëm nga lista e programit elektronik, për të cilin merr vendim në përputhje me ligjin.

Sipas LF, parashikohet një periudhë e detyrueshme adoptimi, e cila zgjat nga 2 deri në 3 muaj (Mickoviq R. , 2015, f. 261). Qendra për Punë Sociale vazhdimisht monitoron periudhën adaptive, dmth monitoron vendosjen e fëmijës në familjen e prindërve të zgjedhur adoptues. Pas përfundimit të periudhës së adoptimit, qendra për punë sociale paraqet një mendim në Komision nëse fëmija duhet të adoptohet nga prindërit e zgjedhur adoptues. (Mickoviq R. , 2015, f. 258) Nëse mendimi i qendrës për punë sociale është pozitiv, Komisioni thërret një seancë në të cilën do të bazohet adoptimi, si dhe merret një vendim për krijimin e adoptimit. (Adoptimi i fëmijës, 2021) Sipas dispozitave ligjore të Republikës së Maqedonisë Veriore, adoptimi është sekret, adoptimi i themeluar nuk mund të ndërpritet dhe marrëdhëniet me të krijohen si me lindjen.

1.3 Adoptimi në të drejtën komperative

Në shoqërinë moderne ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në marrëdhënjet familjare dhe martesore, kanë sjellur ndryshime edhe në sferën e adoptimit. Numri i madh i

natalitetit në shtetet evropiane, si dhe ndihma që e marrin nënat beqare për tu kujdesur për fëmijët e tyre, ka zvogluar në mënyrë të dukshme numrin e fëmijëve pa kujdes prindëror të cilët mund të adaptohen që të jetojnë në një rreth familjar. (Micković R. , 2015, f. 265) Për shkak të kësaj, ekziston një tension midis dëshirës së shumë çifteve të martuara ose individëve që duan të adoptojnë një fëmijë dhe numrit të vogël të fëmijëve që janë të përshtatshëm për t'u adoptuar, gjë që shpesh çon në anashkalimin e rregulloreve ligjore dhe blerjen e të adoptuarit nga prindërit e mundshëm adoptues.

Në të gjitha shtetet e Evropës detyrohet kontrolli i gjyqit ose institucioneve në të gjithë procedurë e adoptimit. Në shumicën e vendeve, gjykata ka një rol kryesor në krijimin e adoptimit, i cili parashikon që ajo ka diskrecionin për të vendosur, në të gjitha rrethanat e çështjes, nëse adoptimi është në interesin më të mirë të të adoptuarit.

1.3.1 Adoptimi në Shqipëri

Sipas kodit të familjes së Shqipërisë adoptimi lejohet vetëm në rast se është në interesin e lartë të të miturit dhe garanton respektimin e të drejtave të tij themelore. (Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimin i Republikës së Shqipërisë, 2014) Në Shqipëri mund të adoptohen vetëm të miturit të cilët kanë një diferencë moshe prej 18 vitesh nga adoptuesi. Për adoptimin e të miturit kërkohet pëlqimi i të dy prindërve të tij. Në qoftë se njëri nga të dy prindërit ka vdekur, nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij ose i është hequr përgjegjësia prindërore, pëlqimi i prindit tjetër është i mjaftueshëm. (Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimin i Republikës së Shqipërisë, 2014, f. 46) Kur fëmijës i kanë vdekur të dy prindërit, kur atyre u është hequr zotësia për të vepruar ose janë të panjohur, gjykata vendos nëse fëmija duhet të adoptohet. Kur adoptuesi është i martuar, duhet të merret pëlqimi i bashkëshortit të tij. Kur i adoptuari ka mbushur moshën dhjetë vjeç merret mendimi i tij dhe në moshën dymbëdhjetë vjeç kërkohet pëlqimi i tij. Prindërit biologjik pëlqimin e tyre për adoptimin e fëmijës së mitur e japin para gjykatës kompetente, e cila mund të tërhiqet mrenda 3 muajve. (Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimin i Republikës së Shqipërisë, 2014, f. 46)

Si adoptues nuk mund të paraqiten persona të cilët e kanë humbur përgjegjësinë prindërore, vuajnë nga ndonjë sëmundje psikike ose i është hequr zotësia e veprimit dhe persona të cilët nuk kanë garancion si person se do e kryejnë në mënyrë të rregullt detyrën e adoptuesit.

Personat të cilët dëshirojnë të adoptojnë duhet të paraqesin kërkesë në gjykatën e vendbanimit të personit që kërkon të adoptojë, gjatë procedurës së adoptimit mund të ndërhyjë çdo person i cili ka një interes të ligjshëm për mbrojtjen e interesit të të miturit. Pas adoptimit në mes adoptuesit dhe të adoptuarit krijohet të drejta dhe detyrime njejtë si në mes prindërve dhe fëmijëve. Në bazë të nenit 262 të Kodit të familjes së Shqipërisë “fëmija i mitur pas moshës dhe pjekurisë së duhur ka të drejtë të njihet me historinë e tij dhe, nëse është e mundur edhe me të dhënat për prindërit biologjikë”. (Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimin i Republikës së Shqipërisë, 2014, f. 46)

1.3.2 Adoptimi në Kosovë

Në Kosovë adoptimi rregullohet me Ligjin për familje i shpallur në gazetën zyrtare të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, Prishtinë. Sipas dispozitave të të njëjtit ligj personat të cilët mund të adoptohen janë fëmijët e mitur, për të cilët duhet të merret pëlqimi paraprak i prindërve biologjikë dhe i vetë fëmijës nëse është në moshë 14 vjeçare. Si adoptues mund të paraqiten bashkëshortët ose një person i vetëm, ku në mes adoptuesit dhe të adoptuarit krijohen të drejta dhe detyrime njejtë si në mes prindërve dhe fëmijëve. (Ligji për Familje, 2006)

Procedura e adoptimit inicohet me kërkesë të personave të interesuar për adoptim përpara gjykatës kompetente, e cila pas mbledhjes së dëshime të nevojshme vendos për themelimin e adoptimit.

Me themelimin e adoptimit krijohen marrëdhënie familjare ndërmjet adoptuesit dhe personave në gjini në njërin anë, dhe ndërmjet të adoptuarit dhe pasardhësve të tij në anën tjetër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, por me themelimin e adoptimit shuhet të drejtat dhe detyrimet e të adoptuarit ndaj prindërve të tij dhe personave në gjini të tjerë në familje si dhe të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe familjes ndaj tij. (Ligji për Familje, 2006, f. 63)

Në bazë të neni 202 të Ligjit për familje të Kosovës “nuk mund të ketë dëshmi të amësisë dhe të atësisë pas adoptimit, pra pas adoptimit nuk lejohet vërtetimi i amësisë ose atësisë së fëmijës së adoptuar”. (Ligji për Familje, 2006, f. 76)

1.3.3 Adoptimi ne Francë.

Në Francës egziston adoptimi i plotë dhe jo i plotë. Secili adoptues është i detyruar të dërgoj vërtetim nga institucioni mjeksor me të cilin do të dëshmoj se nuk ka probleme psikologjike që të paraqitet si adoptues. Në Francë, birësimi është i hapur për këdo mbi moshën njëzet e tetë (i martuar ose jo, që jeton vetëm ose në një çift) dhe për bashkëshortët (jo të ndarë ligjërisht) të martuar për më shumë se dy vjet ose të dy të moshës mbi njëzet e tetë vjet. (Silanoska-Kostadinovska, 2013, f. 271)

Birësimi është gjithashtu i mundur vetëm për njërin nga dy bashkëshortët, nëse ai është mbi njëzet e tetë vjeç dhe me pëlqimin e bashkëshortit të tij. Sidoqoftë, nëse njëri nga bashkëshortët dëshiron të birësojë fëmijën e bashkëshortit të tij, ai mund ta bëjë këtë edhe nëse nuk është njëzet e tetë vjeç. (www.adoption.gouv.fr, 2021)

Partnerët që bashkëjetojnë (ligji i zakonshëm) nuk mund të birësojnë së bashku një fëmijë. Fëmija mund të birësohet vetëm nga një prej partnerëve që bashkëjetojnë (i cili është ligjërisht beqar). Partnerët e një pakti solidariteti civil (PACS) janë në të njëjtën situatë. Dy njerëz duhet të martohen për të birësuar një fëmijë së bashku. Në parim, birësuesi duhet të jetë së paku pesëmbëdhjetë vjet më i madh se fëmija që dëshiron të adoptojë, përveç nëse është fëmija i bashkëshortit të tij (diferenca minimale e moshës e kërkuar nuk është se dhjetë vjet). Gjykatësi mund të lejojë përjashtime për ndryshimet në moshë më të vogla. (Micković R. , 2015, f. 266) Çdo kandidat për birësim (francez ose i huaj), me banim në Francë, i cili dëshiron të marrë për birësim një repart të shtetit ose një fëmijë të huaj duhet së pari të marrë një miratim të lëshuar nga Presidenti i Këshillit të Përgjithshëm pas njoftimit një komision miratimi. Miratimi kërkohet gjithashtu në rast të birësimit brenda familjes, me përjashtim të birësimit të fëmijës së bashkëshortit. Në këto kushte, miratimi mund të lëshohet vetëm për aplikantë të martuar ose për aplikantë të vetëm:

Një kandidat i martuar mund të birësojë së bashku ose vetëm me lejen e bashkëshortit të tij.

Një kandidat i pamartuar që jeton në çift (ligji i zakonshëm, bashkëjetesë, PACS) është ligjërisht beqar dhe për këtë arsye mund të birësojë vetëm. (www.adoption.gouv.fr, 2021)

Në të dy rastet, vlerësimet sociale dhe psikologjike duhet të vërtetojnë se kushtet e pritjes të ofruara nga aplikanti në nivelet familjare, arsimore dhe psikologjike korrespondojnë

me nevojat dhe interesat e një fëmije të birësuar dhe për këtë arsye marrin parasysh përbërjen të shtëpisë ku do të mirëpritet.

Nëse çifti i martuar që ka marrë miratimin e përbashkët ndahet dhe njëri nga të dy dëshiron të mbajë një miratim ose nëse një çift i pamartuar martohet dhe dëshiron miratimin e përbashkët, ata duhet të heqin dorë nga miratimi aktual dhe të kërkojnë një miratim të ri, (pa pasur nevojë të presim për periudhën 30-mujore të vendosur në rast tërheqjeje të miratimit pasi që ky është një aprovim tjetër). (Silanoska-Kostadinovska, 2013, f. 272)

Në të gjitha rastet, statusi martesor dhe kushtet e pritjes po ndryshohen, është i nevojshëm një rivlerësim si dhe një mendim nga komisioni i aprovimit të departamentit.

Kur plani i birësimit ka të bëjë me një fëmijë që jeton jashtë vendit, birësuesit e ardhshëm duhet të plotësojnë edhe kushtet ligjore të përcaktuara nga vendi i origjinës së fëmijës.

1.3.4 Adoptimi në Zvicër

Në të drejtën familjare zvicerane për themelimin e adoptimit, karakteristike është fakti se ligjvënësi ka rregulluar vetëm adoptimin jo të plotë në atë formë që marrëdhënja e cila krijohet me themelimin e saj kufizohet në mes adoptuesit dhe të adoptuarit. Si adoptues në Zvicër mund të paraqiten bashkëshortët, të cilët duhet të jenë më së paku 16 vjet më të mëdhenj se i adoptuari, martesa e tyre të ketë zgjatur më së paku 5 vjet, dhe bashkëshortët të kenë më së paku 35 vjet. Gjithashtu si adoptues mund të paraqiten edhe persona beqar me kusht që të kenë mbushur moshën 35 vjeçare. (Silanoska-Kostadinovska, 2013, f. 272)

Adoptimi në Zvicër themelohet me kontratë të veçantë, në bazë të të cilës i adoptuari bëhet pjesë e familjes së adoptuesit, e cila themelohet në interes të fëmijëve dhe për të cilën merret parasysh edhe pëlqimi i prindërve biologjikë të fëmijës. (www.ch.ch/de, 2021) Në bazë të legjislacionit zviceran ky pëlqim jepet pas gjashtë javëve të para të lindjes së fëmijëve me qëllim të shmangjes së vendimit të shpejtë dhe të gabuar për adoptim të fëmijëve. Pas parashtrimit të kërkesës nga ana e prindërve adoptues dhe dhënjes së pëlqimit nga ana e prindërve biologjikë, organi kompetentë do të miratojë vendimin për adoptim, dhe pas themelimit të adoptimit, e njejta do të shkruhet në librin amë të të lindurve. (Micković R. , 2015, f. 274)

Adoptimi është anonim, në atë mënyrë që prindërit biologjikë të fëmijës nuk mund të dinë identitetin e vërtetë të prindërve adoptues, përveç me pëlqimin e tyre. Çdo fëmijë i adoptuar ka të drejtë të marrë informacion për identitetin e prindërve të tij / saj biologjikë; një fëmijë i adoptuar i cili është i mitur ka këtë të drejtë nëse mund të demonstrojë një interes të ligjshëm. Një fëmijë i birësuar në moshë madhore mund të kërkojë gjithashtu informacioni në lidhje me pasardhësit e drejtpërdrejtë të prindërve të tij / saj të lindjes e cila mund të jepet vetëm nëse pasardhësit janë në moshë madhore dhe janë të pajtuar për zbulimin. Në bazë të nenit 24 të Kushtetutës së Zvicrës së vitit 1992, fëmijët e adoptuar kanë të drejtë që të njohin identitetin e prindërve të tyre biologjikë (www.ch.ch/de, 2021).

1.3.5 Adoptimi në Gjermani

Interesat më të mira të fëmijës janë në zemër të çdo adoptuesi. Kjo do të thotë që prindërit më të mirë po kërkohen për një fëmijë i cili, për arsye të ndryshme, nuk mund të rritet me prindërit e tij të lindur. Qëllimi i një adoptimi është që fëmija të gjejë siguri dhe dashuri në një familje të re. Në të drejtën gjermane që një fëmijë të mund të adoptohet kërkohet pëlqimi i të dy prindërve të lindjes. Pëlqimi i një prindi biologjik mund të hiqet vetëm nëse kërkesat janë të larta, për shembull nëse vendndodhja e nënës ose babait nuk mund të përcaktohet. Nga moshë 14 vjeç, fëmija duhet gjithashtu të japë pëlqimin për adoptimin e tij ose të saj. Për më tepër, kërkohet pëlqimi i përfaqësuesit ligjor. Për fëmijët nën moshën 14 vjeç, vetëm përfaqësuesi ligjor duhet të japë pëlqimin e tyre. Sidoqoftë edhe këtu duhet të respektohet vullneti ose dëshira e fëmijës. (<https://familienportal.de>, 2021)

Në shtetin e gjermanisë për adoptimin vendos gjyqi, adoptuesi duhet të ketë aftësi juridike të pakufizuar sipas ligjit gjerman dhe të ketë së paku 25 vjeç. Një bashkëshort më i ri duhet të jetë së paku 21 vjeç. Nuk ka moshë maksimale ligjore për prindërit birësues, por duhet të ketë një diferencë të moshës midis prindërve adoptues dhe fëmijëve. (Silanoska-Kostadinovska, 2013, f. 273)

Një çift i martuar, i të njëjtit seks ose jo, zakonisht mund të adoptojë vetëm një fëmijë së bashku. Nëse është i mundur një adoptim nga çiftet e të njëjtit seks varet kryesisht nga situata ligjore në vendin e origjinës së fëmijës adoptues. Por beqarët gjithashtu mund të adoptojnë një fëmijë. Përderisa janë plotsuar kushtet për adoptim gjyqi do të sjell vendim për adoptim nëse vërteton se është në interes të fëmijës dhe se mund të krijohet marrëdhënja prindërore në mes

adoptuesit dhe të adoptuarit. Në ligjin gjerman, adoptimi si rregull nuk mund të përfundojë në mënyrë që të sigurojë një mjedis të qëndrueshëm familjar për zhvillimin e të adoptuesit. Me vendosjen e adoptimit, të gjitha lidhjet midis të adoptuarit dhe të afërmeve të tij biologjikë ndërpriten, dhe i adoptuari bëhet anëtar i familjes adoptuese dhe ka të gjitha të drejtat si fëmijë i lindur, duke përfshirë të drejtën e ushqimit dhe të drejtën e trashëgimisë. (Micković R. , 2015, f. 268)

Në rrethana të jashtëzakonshme, adoptimi mund të ndërpritet nëse pëlqimi për adoptim nuk jepet lirshëm ose nëse është çështje mashtrimi, për shembull në lidhje me identitetin e fëmijës që adoptohet. Fëmijët e adoptuar kanë të drejtë të mësojnë rreth prindërve të tyre biologjikë. Nga moshën 16 vjeç kanë një të drejtë të pavarur për të inspektuar agjencinë e vendosjes. Pëlqimi i prindërve adoptues nuk kërkohet më nga 16-vjetori i lindjes së fëmijës. Prindërit adoptues gjithashtu mund të shikojnë skedarët deri në moshën e fëmijës. Agjencia e adoptimit që ndërmjetësoi adoptimin shoqëron inspektimin e dosjeve në të gjitha rastet. Informacioni mbi origjinën dhe historinë e jetës së të birësuarit është i arritshëm. Kjo do të thotë që ju nuk mund ta lexoni të gjithë skedarin. (<https://familienportal.de>, 2021).

Megjithatë, megjithëse mund të ketë arsye për ndërprerjen e adoptimit, ai nuk mund të ndërpritet nëse kanë kaluar tre vjet nga themelimi i tij ose nëse gjykata vendos që ndërprerja e birësimit do të kishte pasoja serioze për mirëqenien dhe interesat e fëmijës së birësuar. (Micković R. , 2015, f. 268).

Kapitulli II

Bioetika dhe riprodhimi artificial

2.1 Bioetika dhe zhvillimi i saj

Çështjet etike që lindin si rrjedhojë e zhvillimit të teknologjisë dhe të shkencave të tjera të aplikuara gjejnë trajtim në disiplinën e bioetikës. Enciklopedia e Bioetikës e përcakton bioetikën si “studimi sistematik i sjelljes njerëzore në fushën e shkencave të jetës dhe të shëndetit, sjellje e cila analizohet nën dritën e vlerave kulturore dhe problemeve morale”. (Zyberaj, 2016, f. 14) Sot, bioetika nuk mund të konsiderohet më vetëm një disiplinë pasi diskutimi mbi çështjet e bioetikës i ka kaluar kufijtë e një diskutimi të thjeshtë shkencor duke u institucionalizuar gjithmonë e më tepër. Tashmë ekzistojnë komitete etike të shumta si në rang ndërkombëtar, rajonal apo kombëtar, të cilat janë institucione ku jo vetëm diskutohet por madje ato japin orientime apo edhe vendime. Në këtë mënyrë fusha e bioetikës njih autoritetet e saja, proceset e saja vendimmarrëse si dhe dokumentat e saja normative duke qënë kështu njësoj e institucionalizuar si degë të tjera të së drejtës.

Fjala “bioetikë” u përdor për herë të parë në vitin 1970 nga biologu Van Renssaler Potter për të emërtuar idenë e tij mbi një lidhje të re mes njohurive shkencore dhe vlerësimit moral. (Micković I. R., 2016, f. 14) Potter e kishte përmendur shprehjen “bioetikë”, për të përshkruar analizën etike për një sërë çështjesh morale që ngriheshin mbi aplikimin e praktikave mjekësore që avanconin nga zhvillimi i biomjekësisë dhe teknologjisë. (ibid, f. 14)

Për shumë shekuj, në shumë kultura të zhvilluara si Greko-Romane, Kristiane, Hinduiste, Konfuciane dhe Islamike, praktikat mjekësore kanë qënë gjithmonë të shoqëruara nga parime të rëndësishme morale. Parimet morale drejtonin mjekët në çdo kohë në ushtrimin e profesionit të tyre. (Zyberaj, 2016, f. 14)

Çështjet etike, morale dhe mjekësore kanë bashkëjetuar për shumë gjatë midis tyre. Në mes të shek XX-të, kjo bashkëjetesë tradicionale midis mjekësisë dhe moralit hasi probleme të paperçedenta. Kushtet në të cilat mjekësia po praktikohet ndryshuan në mënyrë dramatike në shekullin e kaluar. Shkenca pësoi ndryshime dhe zhvillime rrënjësore dhe po ashtu gjithmonë e

më shumë mjekësia aplikohej nga më shumë njerëz. Të gjitha këto zhvillime bënë që parimet morale dhe bashkëvendosja e tyre me ato mjekësore të gjendeshin përpara sfidave të reja. (Jecker N. S, 2012, f. 3)

2.2 Riprodhimi artificial dhe çështjet etike

Konkretizimi i teknologjisë riprodhuese në vitin 1978 ngriti një debat etik mbi mënyrën e përdorimit të kësaj teknologjie inovative. Çështjet kryesore që shtroheshin për diskutim i drejtoheshin faktit nëse zhvillimi i mëtejshëm i këtyre teknologjive do të dëmtonte mirërritjen e fëmijës, do të dëmtonte prindërimin, apo do të ndikonte në kuptimin e riprodhimit. Aplikimi i këtyre metodave dhe lindja e fëmijëve të parë nga riprodhimi artificial si dhe rregullimi ligjor i realizuar nga disa shtete perëndimore bëri që aplikimi i këtyre metodave të konsiderohej i pranueshëm nga pikëpamja etike. (Zyberaj, 2016, f. 15) Një arsye më shumë për të përkrahur metodat e riprodhimit artificial ishte dhe për shkak të faktit që këto metoda u mundësonin çifteve infertile të linin pasardhës, duke e bërë këtë proces të ngjante sa më i natyrshëm. (Zyberaj, 2016, f. 15) Por ishte koha kur riprodhimi artificial realizohej vetëm tek një çift bashkëshortësh, pa pjesmarrjen e dhuruesve por me pjesmarrjen e të dy prindërve dhe si rrjedhojë fëmija trashëgonte gjenetikisht të dy prindërit dhe ai vinte në jetë brenda një familje tradicionalisht të strukturuar. (Micković I. R., 2016)

Pas viteve 1990 teknologjia e riprodhimit artificial u zhvillua me shpejtësi, bioteknologjia bëri të mundur aplikimin e formave të reja të riprodhimit artificial përmes pjesmarrjes së një dhuruesi, riprodhimit jashtë trupit të femrës apo përmes surrogacisë. Të gjitha këto forma të reja të riprodhimit artificial vendosën sërish në vëmendje pyetjet e lartëpërmendura. Tani është e vështirë të thuhet se këto metoda riprodhuese ngjanin me riprodhimin natyror. Format e reja të teknologjisë riprodhuese përveç prindërve ligjorë të fëmijës përfshijnë edhe persona të tretë siç janë dhuruesit e materialit gjenetik ose nëna që do të mbarti gjatë shtatëzanisë së saj fëmijën. Është e nevojshme të përcaktohet statusi i personave të tretë dhe marrëdhëniet ligjore të tyre me prindërit e fëmijëve dhe me vetë fëmijën. Fëmija i lindur prej këtyre metodave mund të mos ketë asnjë lidhje gjaku me prindërit ligjorë të tij dhe mund që ai të mos përfshihet në një familje tradicionale pasi edhe homoseksualët apo beqarët heteroseksual tani më kanë akses më të madh në këto teknika. (Zyberaj, 2016, f. 15)

Pyetja e parë etike që lind nga përdorimi i këtyre teknologjive është; a duhet të përdoren këto metoda?

Përgjigja e kësaj pyetje duhet parë në përputhje edhe me qëndrimet fetare duke patur parasysh se feja ka një ndikim të konsiderueshëm në krijimin dhe ruajtjen e parimeve morale dhe etike. Tradita fetare të ndryshme mbajnë qëndrime të ndryshme në lidhje me përdorimin e këtyre teknikave. Kisha Katolike e Romës, i ka deklaruar teknikat e reja të riprodhimit artificial moralisht të papranueshme, pasi ato ndajnë nga akti seksual riprodhimin dhe lindjen ndërkohë që sipas Kishës Katolike, këta element janë ngushtësisht të lidhur me njëri tjetrin. “Ngjizja e një fëmijë duhet të përfshijë bashkimin shpirtëror dhe dashurinë fizike të prindërve. Fertilizimi jashtë trupit është i privuar nga kuptimi dhe vlerat e shprehura në gjuhën e trupit dhe në bashkimin fizik të personave.” (Zyberaj, 2016, f. 15)

Grupime të tjera fetare si luteranët, anglikanët, hebrenjtë, islamikët etj, i konsiderojnë disa prej këtyre metodave si të pranueshme nga pikëpamja etike pasi Zoti inkurajon riprodhimin. Sipas tyre është e nevojshme që dashuria dhe riprodhimi të jenë pjesë e jetës martesore, por nuk është e nevojshme që çdo akt seksual të çojë në ngjizjen e fëmijëve.

Feministët po ashtu janë të ndarë në qëndrimin e tyre mbi çështjet e riprodhimit artificial. Disa janë të mendimit se këto metoda të reja, i përcaktojnë dhe i limitojnë femrat si “mbajtëse të fetusit”. Ata mendojnë se shoqëria u bën një përcaktim të tillë femrave duke patur parasysh faktin se dëshira më e madhe e tyre, (qofshin ato fertile ose infertile), është të kenë fëmijë. (Jaggar, 1983) Presioni që shoqëria krijon mbi femrat duke vënë në konsideratë kryesisht funksionin e tyre riprodhues, i vendos ato nën një presion të vazhdueshëm psikologjik dhe fizik. (Zyberaj, 2016, f. 16)

Në kundërshtim me mendimin e parë, grupi tjetër i feministëve mendon se aplikimi i metodave të reja të riprodhimit artificial rrit mundësinë e zgjedhjes për femrat. Duke luftuar infertilitetin por edhe duke rritur edhe mundësitë për forma të reja riprodhimi, këto teknologji zgjerojnë zgjedhjet për riprodhim dhe të drejtat e riprodhimit. (Jaggar, 1983)

Zhvillimet teknologjike shpesh herë tentojnë të modifikojnë shoqërinë dhe parimet në të cilat ajo mbështetet. Çështjet mjekësore dhe teknologjike gjithmonë kanë ngritur për diskutim problemet morale me të cilat ato implikohen, duke kërkuar kështu përgjigje të cilat duhet të synojnë një raport të rregullt midis vlerave morale shoqërore por edhe në

mospengimin e zhvillimive mjekësore dhe teknologjike. Riprodhimi artificial i realizuar qoftë edhe në format më të thjeshta të tij, ngre pikëpyetje të shumta etike dhe morale. Duke u lidhur me një të drejtë shumë personale të njeriut siç është e drejta për riprodhim, pyetjet që ngrihen janë të shumta si: kush e ka të drejtën të riprodhohet sipas këtyre teknikave, si dhe kur do të mund ti nënshtrohet, cili do të jetë prindi dhe si do të garantohet interesi më i lartë i fëmijës? (Zyberaj, 2016, f. 17)

Çështje etike, mjekësore, sociale dhe ligjore ngrihen pothuajse në çdo fazë të realizimit të riprodhimit artificial duke filluar që nga gametët e përdorur e deri tek respektimi i interesit më të lartë të fëmijës dhe përcaktimi i statusit të tij (Carcani, 2018). Disa prej çështjeve etike që shtrohen në rastin e riprodhimit artificial janë:

2.2.1 Prejardhja e gametëve

Në rastin kur riprodhimi artificial është homolog, (pra realizohet përmes të dy partnerëve), çështja etike që shtrohet është ajo e realizimit të aktit seksual midis një mashkulli dhe një femre që duhet të jetë edhe forma e vetme e riprodhimit. (Zyberaj, 2016, f. 17) Realizimi i kësaj forme riprodhimi bën të humbasë aspekti njerëzor dhe bashkimi emocional-fizik midis partnerëve. (Zyberaj, 2016, f. 17) Kjo çështje etike merr përmasa edhe më të mëdha kur prejardhja e gametëve është vetëm e njërit prej partnerëve ose prej asnjërit prej tyre (riprodhim artificial heterolog ose surrogat). Një pjesë e mbështetësve të riprodhimit artificial e justifikojnë këtë problem etik me mundësinë që riprodhimi artificial u jep shumë çifteve të cilat për shkak të infertilitetit nuk mund do të riprodhohen në mënyrë natyrore. (Zyberaj, 2016, f. 17)

2.2.2 Statusi i fëmijëve

Në rastet e riprodhimit artificial heterolog ose surrogat statusi biologjik i fëmijës nuk përputhet me statusin ligjor dhe social të tij. (Zyberaj, 2016, f. 17) Në rastin e riprodhimit artificial me dhurues të panjohur statusi ligjor i fëmijës nuk do të vihet ndonjëherë në pikëpyetje për sa kohë nuk njihet dhuruesi dhe nuk dihet prejardhja e plotë biologjike e fëmijës (Zyberaj, 2016, f. 17). Por nëse dhuruesi është një dhurues i njohur atëherë statusi ligjor i fëmijës do të vihet në pikëpyetje në raport me statusin biologjik të tij. I njëjti problem etik shfaqet edhe në rastin e nënës surrogate. Fëmijët janë konsideruar si “gjaku i gjakut” çka

tregon edhe për domethënien e fortë që ka lidhja biologjike midis prindit dhe fëmijës. Aq e rëndësishme është kjo lidhje sa legjislacionet i njohin mundësinë si prindit ashtu edhe fëmijës të kërkojnë realizimin e të vërtetës biologjike duke arritur një përputhje midis statusit ligjor dhe atij biologjik. (Zyberaj, 2016, f. 17)

2.2.3 Statusi i prindërve

Metodat e riprodhimit artificial përfshijnë risqe psikologjike dhe fizike, jo vetëm për prindërit ligjor që do ti nënshtrohen këtij riprodhimi, por edhe për dhuruesin apo nënën surrogate. (Zyberaj, 2016, f. 18) Riprodhimi artificial ndikon mbi disa të drejta themelore siç janë e drejta për riprodhim dhe e drejta e privatësisë. (Micković I. R., 2016) Për personat që do t'i nënshtrohen riprodhimit artificial ngrihen një sërë çështjesh etike si:

- a) E drejta për akses në riprodhimin artificial si pjesë e ushtrimit të së drejtës për riprodhim; Një çështje thelbësore në debatin etik mbi riprodhimin artificial lidhet me diskrecionin individual të çdo njeriu për t'iu nënshtroar teknikave të riprodhimit artificial si pjesë e ushtrimit të së drejtës së tyre për riprodhim. (Zyberaj, 2016, f. 18) Që të ndalohet aksesin në një të drejtë të tillë, siç është e drejta për riprodhim, duhet që shteti të provojë se ushtrimi i kësaj të drejte do të shkaktojë dëm mbi personat që do t'i nënshtrohen kësaj procedurë ose mbi fëmijët e lindur si rrjedhojë e zbatimit të këtyre teknikave. Jurisprudenca ka mbështetur idenë se njerëzit janë të lirë të zgjedhin nëse do të riprodhohen ose jo, të zgjedhin se me kë dhe metodat të cilave ata do t'i nënshtrohen. Ata kanë të drejtë që për të realizuar aksesin e tyre në teknikat riprodhuese, të lidhin marrëveshje me persona të tretë nga të cilët mund të ndihmohen në përpjekjet e tyre për riprodhim. (Zyberaj, 2016, f. 18) Megjithatë kundërshtarët e përdorimit të metodave të riprodhimit artificial i konsiderojnë si të papranueshme aplikimin e tyre dhe sipas tyre nevoja për kufizim vjen si rrjedhojë e dëmit emocional apo psikologjik, që aplikimi i këtyre teknikave mund të shkaktojë tek fëmijët e lindur.
- b) Orientimi seksual i prindërve; në vitet e fundit vihet re një rritje e numrit të çifteve homoseksuale të cilët aksesojnë metodat e riprodhimit artificial kryesisht në vendet e Evropës perëndimore. (Zyberaj, 2016, f. 18) Përkrahësit e fesë llobojnë ende për ndalimin e aksesit në riprodhimin artificial të kësaj kategorie duke arsyetuar si jo natyrore dhe duke e lidhur qëllimin e riprodhimit artificial vetëm në aspektin mjekësor

të tij, mundësinë e çifteve infertil për t'u riprodhuar dhe për të lënë pasardhës. Shtetet të cilat u kanë dhënë mundësinë e aksesit në këto teknika homoseksualëve kanë arsyetuar mundësinë e këtij aksesit me të drejtën për riprodhim të çdo individi dhe të drejtën për të lënë pasardhës. (Zyberaj, 2016, f. 18)

- c) Pamundësia financiare; aksesit në metodat e riprodhimit artificial është një proces i cili kërkon shpenzime jo të pakta financiare, çka bën që shumë çifte të cilët janë infertil të jenë në pamundësi për t'iu nënshtruar këtyre metodave. Në disa vende metodat e riprodhimit financohen pjesërisht ose plotësisht nga skema e sigurimit shëndetësor kur plotësohen kriteret e kërkuara nga ligjet kombëtare. Por ende në shumë vende këto teknika rëndojnë mbi buxhetin e pjesmarrësve. Në Maqedoninë e Veriut riprodhimi artificial, pavarësisht se përfshihet në listën e shërbimeve të rimbursuara nga skema e kujdesit shëndetësor, realizohet vetëm në klinika private dhe kostua e këtij shërbimi edhe pse më e ulët se në vendet e tjera të Evropës, është një kosto e papërbalueshme në raport me nivelin mesatar të jetesës. (Zyberaj, 2016, f. 19) Nga pikëpamja etike kostua e lartë e këtij shërbimi përbën një pengesë për aksesin në të, të personave infertile dhe pa mundësi financiare, ndërkohë që jep përshtypjen e një shërbimi i cili u ofrohet vetëm personave me mirëqënie ekonomike. Një tjetër shqetësim etik është ai i shpërblimit të dhuruesve të gametëve. Disa autorë mendojnë se pagimi i dhuruesve të gametëve i kthen gametët dhe qelizat njerëzore si pjesë e tregut mbi të cilat mund të kontraktohet mbi çmimin. Këta autorë pretendojnë se gametët si mjete që bëjnë të mundur ardhjen në jetë të një fëmije nuk duhet të shihen si produkte që mund të blihen dhe shiten në treg. Për më tepër vlerësimi monetar i gametëve do të ndikonte mbi vullnetin e dhuruesve për të dhuruar, duke e kthyer atë në një formë përfitimi komod përmes shitjes së qelizave të tyre. Përkrahësit e idesë se dhuruesit duhet të paguhet për dhurimin e qelizave të tyre e bazojnë mendimin e tyre në autonomin dhe të drejtën e gjithkujt për të zgjedhur përdorimin e trupit të tyre (Zyberaj, 2016, f. 19). Ndërhyrja e shtetit në këtë rast për të ndaluar shitjen e gametëve nuk është gjë tjetër veçse cënim i të drejtës për të zgjedhur. (Zyberaj, 2016, f. 19) Sipas tyre problemi kryesor nuk është tregu i gametëve si i tillë, por mungesa e një tregu me çmime të rregulluara ku të garantohet se çdo dhurues duhet të marrë pagesën e drejtë që i përket. Legjislacionet e

shumicës së vendeve të Evropës perëndimore nuk përcaktojnë shpërblim për dhuruesin e gametëve, përkundrazi e ndalojnë një gjë të tillë, por në disa raste parashikohet se dhuruesit duhet të rimbursohen për kohën e humbur dhe për shqetësimin. Si rrjedhojë dhuruesit duhet t'i paguhen shpenzimet e udhëtimit, paga e humbur, analizat mjekësore dhe risku që ata marrin përsipër gjatë nënshtrimit ndaj këtyre procedurave. Të përcaktosh nëse ndaj dhuruesve duhet të ketë apo jo shpërblim dhe nëse do të ketë një treg dhuruesësh apo jo, është një çështje e cila lidhet sa me të drejtën e gjithësecilit për të vendosur mbi trupin e tij aq edhe me parimet e rëndësishme morale për të mos e kthyer trupin e njeriut në një vlerë tregu. (Zyberaj, 2016, f. 19) Vendosja e një çmimi për dhurimin e gametëve mund të çonte në një treg ku personat më të varfër dhuronin jo për qëllim, por për të krijuar një mënyrë jetese. Nga ana tjetër mungesa e një çmimi të tillë bën që të bjerë numri i dhuruesve për shkak të disinteresimit dhe mos motivimit të tyre. (Zyberaj, 2016, f. 19)

- d) Moshë e gruas; Për herë të parë diskutimi mbi moshën e gruas që do t'i nënshtrohej teknikave të riprodhimit artificial u shtrua rreth 13 vjet më parë, (Zyberaj, 2016, f. 20) kur u mendua se riprodhimi artificial mund të aplikohet edhe tek gratë që e kanë kaluar moshën e menopauzës dhe që biologjikisht janë infertile. (Zyberaj, 2016, f. 20) Çështjet etkike që ngrihen në këtë rast lidhen me aksesin në këto teknika të grave në moshë menopause dhe nëse një akses i tillë do të jetë i mundshëm, sa duhet të jetë moshë maksimale për aplikimin e këtyre teknikave. Autorë të ndryshëm mendojnë se një mundësi e tillë nuk u duhet dhënë grave në moshë menopauze për shkak të pamundësisë së tyre për të jetuar gjatë dhe për t'u kujdesur fizikisht dhe emocionalisht për fëmijën e tyre (Zyberaj, 2016, f. 20). Ndërkohë që të tjerë përkrahin mendimin se aksesin në teknika të tilla i duhet dhënë kujtdo pa aplikuar limite moshe. Një tjetër kritikë që i bëhet kësaj metode riprodhimi arsyetohet në baze të strukturës së familjes. Sipas tyre, femrat në këtë moshë janë të paracaktuara nga natyra për të luajtur rolin e gjyshes dhe jo atë të nënës. Mundësia e riprodhimit të tyre trondit rolet e përcaktuara brenda familjes. Megjithatë edhe burrat në moshë të madhe kanë mundur të sjellin në jetë fëmijë të tyre pa qënë objekt kritikizmi, por kjo mundësi e tyre është tërësisht një

mundësi natyrore dhe biologjike dhe kjo nuk do të thotë se duhet të zbatohet njësoj edhe për gratë në moshë menopauze. (Zyberaj, 2016, f. 20)

2.3 Metodat e Riprodhimit Artificial. Riprodhimi Homolog dhe Heterolog

2.3.1 Infertiliteti dhe shkaqet e tij

Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka konsideruar infertilitetin si një patologji. Me infertilitet kuptohet pamundësia e ngjizjes pas një periudhe 24 mujore të raporteve seksuale të pambrojtura. Të dhënat tregojnë se në vendet e industrializuara infertiliteti arrin në shifra shqetësuese. Një çift në gjashtë kalon probleme infertilitetit në ciklin e parë ose në ciklet e tjera të tyre. Kjo organizatë e ka klasifikuar infertilitetin si një sëmundje. Infertiliteti çon në paaftësi dhe si rrjedhojë aksesit në kujdesin shëndetësor do të garantohet nga Konventa e të Drejtave të Personave me Paaftësi. Infertiliteti tek femrat është konsideruar si një ndër pesë shkaqet më të rënda të paaftësisë për personat që janë nën moshën 60 vjeç. (www.who.int, 2021)

Koha është një ndër faktorët kryesor që duhet të merret parasysh. Pasi kanë kaluar dy vjet përpjekjesh për të ngjizur, 19-20% e çifteve kishin probleme të konceptimit. Nga këta 4 % do të mbeten infertile kurse pjesa tjetër 15% do t'u duhet një kohë më e gjatë për të konceptuar në krahasim me çiftet normale fertile (3 ose 4 vjet). Përveç kohës, element shumë i rëndësishëm është edhe moshja e gruas. Rreziku për infertilitet i një gruaje në moshën 35-44 vjeç është sa dyfishi i rrishtit të infertilitetit të një gruaje të moshës 30-34 vjeç. (bioetica.governo.it, 2021)

Shkaqet që çojnë në infertilitet janë nga më të ndryshmet. Përveç moshës së gruas që vlerësohet si një element i rëndësishëm, mjekësia i lidh shkaqet e infertilitetit edhe me faktorët social të lidhur me fenomenet komplekse të mënyrës së jetesës si; përdorimi i drogave, abuzimi me alkoolin, duhanpirja, ndotja, kushtet e punës etj. Po ashtu edhe mbipesha në kufijtë e obezitetit ose dobësimit mund të jenë shkaqe të infertilitetit.

Infertiliteti ndahet në infertilitet parësor dhe infertilitet dytësor. Infertiliteti parësor ndodh kur gruaje nuk është e aftë për të rënë shtatëzanë ose për të mbajtur një shtatëzani. Kur një grua nuk është në gjendje të fertilizohet natyrisht, kur ajo nuk mund të mbarti një shtatëzani ose kur nuk ka mundur të përfundojë një shtatëzani në një lindje gjallë, por kur së

paku e ka kryer më përpara një lindje gjallë, do të konsiderohet si infertilitet dytësor ose e thënë ndryshe do të konsiderohet jo fertile në të dytën herë.

Nga matja e niveleve të infertilitetit për 20-vjet, vihet re se nivelet e infertilitetit në vitin 2010 nuk kanë pësuar ndryshim në raport me ato të vitit 1990, por në raport me rritjen e numrit të popullsisë, numri absolut i çifteve të prekura nga infertiliteti është rritur nga 42 milion në vitin 1990 në 48.5 milion në vitin 2010 (journals.plos.org). Megjithatë vihet re se përqindja e femrave me infertilitet parësor është më e ulët se ato me infertilitet dytësor. 1.9% e femrave ishin të rrezikuara ndaj infertilitetit parësor kundrejt 10.5 % të tyre të cilat riskonin infertilitetin dytësor (journals.plos.org, 2020).

2.3.2 Teknikat e riprodhimit artificial

Tendencat e riprodhimit kanë pësuar ndryshime të rëndësishme si në aspektin pozitiv (të nevojës për riprodhim) dhe në atë negativ (të kufizimit të riprodhimit). Riprodhimi jo vetëm që nuk shikohet më si funksioni kryesor i femrës së pjekur seksualisht, por nga ana tjetër shtetet kanë ndërmarr edhe politika të planifikimit familjar si dhe të kontrollit të riprodhimit. Tendenca tjetër e riprodhimit, e mbështetur edhe nga zhvillimi i teknologjisë, është ajo e mundësisë së riprodhimit edhe në kushte “jo natyrore” për ata që dëshpërimisht kërkojnë fëmijë. Fillimi i jetës njerëzore përmes kontaktit të spermës me vezën, nuk është më një prerogative vetëm e natyrës por edhe e aplikimit të teknikave relative (Filip, 2020, f. 7). Ndërhyrja e njeriut përmes këtyre teknikave mund të realizohet në çdo fazë të riprodhimit, brenda ose jashtë trupit të femrës. Si rrjedhojë e zbatimit të këtyre teknikave, mund të realizohen disa mënyra të riprodhimit artificial duke filluar nga ato sa më afër natyrores, e deri tek ato metoda të cilat janë gjithmonë e më tepër larg nga riprodhimi natyror. Kështu mund të kalojmë nga teknikat e riprodhimit artificial, prej të cilave fëmijët janë identikisht të ngjashëm dhe të lidhur gjenetikisht me prindërit, në ato ku fëmija dhe prindi nuk kanë asnjë lidhje biologjike midis njëritjetrit. Krahas faktit që riprodhimi artificial i dha mundësinë një çifti të realizonte funksionin riprodhues, këto teknika u dhanë mundësinë edhe individëve të vetëm të riprodhohen pa qënë e nevojshme të kenë një partner por që, mund të përdorin materialin e një personi të tretë i cili mund të jetë i panjohur për ta.

Të dhënat historike tregojnë se teknikat e para të riprodhimit artificial mund të jenë përdorur qysh në Shek. XV nga Mbreti Henri i IV i Kastilies, i quajtur ndryshe edhe si “impotenti”. Mbreti Henri u martua me Princeshën Juana, motra e Alfonsit të V të Portugalisë dhe pas gjashtë vjet martese erdhi në jetë vajza e tyre Joanna. Princësja e vogël Joanna përflietej se nuk ishte vajza e mbretit për shkak të impotencës së tij dhe mungesës së ngjashmërisë së saj me të atin. Filloi të flitej për mundësinë e një riprodhimi artificial, pavarësisht se të dhëna zyrtare nuk gjenden. Për disa shekuj me rradhë studiues të ndryshëm kanë bërë përpjekje për të realizuar metodat e riprodhimit artificial duke studiuar gametët femëror dhe mashkullorë si dhe mundësinë e bashkimit të tyre në mënyrë artificiale jashtë trupit të femrës. Përpjekjet e para të dokumentuara për aplikimin e teknikave të riprodhimit artificial datojnë në vitet 1770, në Londër nga John Hunter i cili tentoi të mblidhte gametët mashkullor dhe t’i vendoste ata në vaginën e femrës me qëllim riprodhimin. (Zyberaj, 2016, f. 24) Nuk ka të dhënë nëse këto teknika të përdorura nga Hunter kanë rezultuar të sukses Fëmija regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe do të ketë të drejtën për një emër, të drejtën e kujdesit, shtetësinë dhe, për aq sa është e mundur, të drejtën për të ditur se kush janë prindërit e ti shme. (Ombelet W, 2010)

Intensivisht përpjekjet për të realizuar foshnjën e parë të lindur përmes këtyre teknikave të riprodhimit artificial filluan qysh në vitet ’50 të shek XX, por ato do të jepnin rezultat 28 vjet më vonë me lindjen e foshnjës së parë, Louise Brown (1978). Në fillim të viteve ’80, teknikat e riprodhimit artificial nuk ishin më të dyshimta në rezultatet e tyre, madje ato filluan të tentonin për më tepër (Zyberaj, 2016, f. 25). Aplikimi i teknikave të riprodhimit artificial krijuan një mundësi të re për konceptim duke e ndarë kështu konceptin e seksualitetit (si akti natyror i bashkimit të gametëve i cili mund të çoj ose jo në ngjizje), nga riprodhimi si bashkim gametësh me qëllim ngjizjen. (Micković I. R., 2016, fv. 7-8).

Teknologjia riprodhuese ndryshon formimin e familjeve, por nuk ka nevojë të sfidojë ligjet që rregullojnë familjet. Familjet ende mund të përbëhen nga partnerë intimë, fëmijët e tyre ose të dy, dhe ende kanë nevojë për privatësi dhe mbrojtje. Sidoqoftë, teknologjia riprodhuese ka përmirësuar formimin e familjeve që nuk përbëhen nga dy prindër heteroseksualë dhe fëmijët e tyre, duke siguruar mundësi për burra dhe gra të vetme dhe çifte homoseksuale dhe lezbike për të lindur fëmijë. (Cahn, 2012, f. 374) Kjo pjesë ofron kontekstin

për të shqyrtuar rregullimin e mëtejshëm të botës së dhuruesve. Ai përshkruan familjet e konceptuara nga donatorët dhe bashkësitë familjare të krijuara nga donatorët, së pari duke eksploruar popullsinë dhe gjuhën e botës së dhuruesve. Më pas i drejtohet hulumtimit mbi kuptimin e lidhjeve brenda kësaj bote. Dhurimi i spermës ka ekzistuar me shekuj, por ka qenë një praktikë mjaft e fshehtë - dhuruesit e parë të spermës ishin shpesh studentë të mjekësisë, të cilët dhanë spermën në mënyrë anonime. Në rastin më të hershëm të dokumentuar të dhurimit të spermës, nëna mesa duket as nuk e dinte që spermatozoidi i burrit të saj nuk ishte përdorur. (Cahn, 2012, f. 374)

Kur njerëzit përpiqen të krijojnë familje duke përdorur materialin gjenetik të njerëzve të tjerë, ata mund të kenë akses në vezët e dhuruesve, spermatozoidet ose embrionet. Të dy vezët e dhuruesve dhe embrionet kërkojnë përfshirjen e një mjeku ose klinike të fertilitetit, dhe pacientët zakonisht i nënshtrohen fekondimit in vitro (IVF). (Corral, 2001) Dhuruesit e vezëve mund të ndihen disi të papërgatitur për efektet afatshkurtra dhe afatgjata morale, fizike dhe psikologjike të dhurimit, dhe disa ish-dhurues të vezëve kanë kërkuar rregullim më të madh të dhurimit. Ofruesit e vezëve që kërkojnë mbrojtje të mëtejshme në procesin e dhurimit mund të shprehin shqetësim në lidhje me anonimitetin dhe kurrë nuk njohin ndonjë fëmijë të lindur nga gamet e tyre, si dhe rreziqet shëndetësore dhe mungesën e zbulimit dhe kujdesit. (Margaret Nelson, 2015, fv. 39–67) Përveç pëlqimit të përgjithshëm të informuar për procedurat mjekësore, nuk ka asnjë ligj që kërkon që dhuruesit të marrin ndonjë informacion specifik në lidhje me rreziqet e panjohura të dhurimit të vezëve, dhe as që të sigurohet kujdes shëndetësor pasues. Për më tepër, gjithashtu nuk ka kufizime në numrin e fëmijëve që mund të prodhohen si rezultat i gameteve të ndonjë dhuruesi individual.

Riprodhimi artificial mund të realizohet në disa mënyra; ose përmes stimulimit me medikamente me bazë hormonesh për të krijuar një numër më të madh vezësh, marrja e vezëve dhe bashkimi i tyre me spermatozoidët (kur bashkimi natyror i tyre nuk mund të realizohet) dhe rivendosja e embrioneve të përfituara në uterus. (www.mayoclinic.org, 2021) Pavarësisht rrugës që ndjekin gametët për fertilizim, prejardhja e tyre mund të jetë e ndryshme. Gametët mund të jenë të një çifti që kërkojnë të riprodhohen, mund të jenë të personi të tretë i cili është i huaj (dhuruesi) për personin që riprodhohet, ose mund që të jenë gametë të cilët janë ruajtur të ngrirë.

Një tjetër metodë e riprodhimit artificial, e cila nuk lidhet me anomalinë e ngjizjes më tepër se me atë të mbajtjes së shtatëzanisë dhe mundësisë për të lindur një fëmijë gjallë, është edhe surrogacia. Përmes surrogacisë embrioni i formuar implementohet në mitrën e një femre tjetër e cila do të vazhdojë shtatëzaninë deri në përfundim të saj dhe lindjen gjallë të fëmijës. Fëmija i lindur nga nëna surrogate i përket çiftit ose personit që ka porositur shtatëzaninë. Në përmbledhje këto metoda karakterizohen si: metoda të nivelit të parë, në të cilat gametët nuk nxirren jashtë trupit të femrës por fertilizimi synohet të realizohet brenda trupit të saj dhe metoda të nivelit të II dhe të III, në të cilat fertilizimi është i pamundur të realizohet brenda trupit të femrës por fertilizimi realizohet jashtë trupit të saj dhe embrioni vendoset më pas në trupin e femrës ose të një femre tjetër që do të mbarti shtatëzaninë. (Zyberaj, 2016, f. 28) Teknikat e riprodhimit artificial mund të klasifikohen në; teknikat e dhurimit të gametëve, ngrirja e gametëve, dhurimi i embrionit dhe surrogacia. (Zyberaj, 2016, f. 28)

Teknikat e dhurimit të gametëve

Teknikat e dhurimit të gametëve janë teknika të riprodhimit artificial heterolog. (Filip, 2020) Ato realizohen në ato raste kur të paktën njëri prej partnerëve është steril dhe kur materiali i tij nuk është i përshtatshëm për riprodhim për shkak të sëmundjeve gjenetike të trashëgueshme. Përmes këtyre teknikave mund të dhurohen si gametët mashkullor (sperma) ashtu edhe gametët femëror (vezët). Përparësia e këtyre teknikave qëndron në faktin që fëmija ka lidhje gjenetike të paktën me njërin prej prindërve kurse me tjetrin ka një lidhje ligjore. Përpara nisjes së procedurave të riprodhimit artificial prindërit e ardhshëm të fëmijës duhet të japin pëlqimin e tyre për realizimin e këtyre teknikave, gjë e cila është e nevojshme për të përcaktuar statusin ligjor të fëmijës. (Çili, 2018) Si dhurues në këto teknika mund të përdoren si persona të cilët janë të afërm të familjes ose të njohur të prindërve dhe në rast të mungesës së tyre, do të përdoren dhurues të panjohur të kontraktuar nga qendra shëndetësore në të cilën do të realizohet implementimi i gametëve.

Padyshim që dhurimi i gametëve është një mundësi alternative riprodhimi në rastin kur të paktën njëri prej partnerëve është steril ose vuan nga sëmundje të rrezikshme dhe gjenetike të trashëgueshme. Si e mëtejshme mund të përmendet fakti i mungesës së lidhjeve gjenetike midis fëmijës dhe të paktën njërit prej prindërve të tij, por edhe çënimin e të drejtës së fëmijës për të njohur prejardhjen e tij biologjike. (Zyberaj, 2016)

Dhurimi i embrionit

Dhurimi i embrionit, ose i quajtur ndryshe edhe si “birësimi prenatal”, i jep mundësinë prindërve jo vetëm të bëhen me fëmijë por edhe të përjetojnë shtatëzaninë. Këto teknika u vijnë në ndihmë atyre çifteve të cilët për arsye infertilitetit, sterilitetit apo sëmundje të trashëgueshme nuk mund të përdorin asnjëri gametët e tyre. (Draškić) Si rrjedhojë, fëmija i lindur nga këto teknika nuk ka lidhje gjenetike me asnjë prej prindërve ligjor të tij. Përdorimi i kësaj teknike, përveç se ngre çështje të shumta etike, has edhe në vështirësinë e përcaktimeve ligjore të prindërve të fëmijës. Cila do të jetë nëna e fëmijës, dhuruesja apo nëna që ka mbartur shtatëzaninë?

Kapitulli i III

3.1. Njohja e prejardhjes - një element thelbësor i identitetit personal

Dinamika e ndryshimit shoqëror në kontekstin e globalizimit gjithashtu ka një ndikim në procesin e konceptimit të një fëmije, i cili nuk është gjithmonë biologjik. Prandaj, tendenca e politikës moderne familjare është të përmirësojë të gjitha metodat riprodhuese biomjekësore për konceptimin e një fëmije dhe të ndjekë nevojat e çifteve të cilëve u mohohet mundësia e prindërimit natyror. (Arta Selmani, 2017, f. 3) Përparimet në shkencën e së drejtës familjare dhe biomjekësinë kanë kontribuar në promovimin e formave të reja të riprodhimit njerëzor përmes të cilave mund të vendoset prindërimi. Janë këto teknologji të reja riprodhuese artificiale (VRT - fertilizmi artificial, fekondimi in vitro, surrogacia) për konceptimin e një fëmije, si dhe birësimi, janë koncepte që lidhen ngushtë me të drejtën e fëmijës që një periudhë të caktuar të jetës së tij ndjen nevojën për të zbuluar origjinën e tij. (Micković D. , 2011, f. 521)

E drejta e fëmijës për identitet personal i referohet njohjes me faktin se kush janë prindërit e tij biologjikë dhe e drejta për të vendosur dhe mbajtur marrëdhënie personale nëse të dy palët tregojnë interes për të. Sigurisht, respektimi i të drejtave të fëmijëve përmbush një nga kërkesat e ligjit familjar, dhe kjo është respektimi i dinjitetit njerëzor. E drejta për dinjitetin njerëzor kategorizohet si një e drejtë e patjetërsueshme. Sipas kësaj të drejte, çdo qenie

njerëzore ka të drejtën e vlerës dhe respektit shoqëror, dhe "jeta në zhvillim" (embrioni) si dhe njeriu pas vdekjes mbulohet nga mbrojtja e të drejtës së dinjitetit. (Galiç, 2013, f. 118) Dinjiteti njerëzor në raport me ligjin modern të familjes reflektohet më së shumti në institucionin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e personave të privuar nga zotësia juridike. Përmbledhja e këtyre instituteve, për të cilat interesi po rritet si arsye për ndryshimin e vetëdijes për shkak të rrezikimit të një kategorie të caktuar personash, na jep mundësinë të studiojmë bazën e tyre ligjore. Në këtë pjesë, natyrisht, është përgjigjja rreth cilësisë dhe fushëveprimit të dinjitetit njerëzor të personave si anëtarë të një familjeje. (Arta Selmani, 2017, f. 4) Prandaj, përveç të gjitha të drejtave specifike të fëmijës, të cilat garantohen nga instrumentet ndërkombëtare, veçanërisht Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) (Clark, 2012, f. 650), theksohet veçanërisht e drejta e fëmijës për identitetin e tij. Termi identitet interpretohet nga disa aspekte: aspekti juridik, personal, psikologjik, sociologjik për të cilin jepen përkufizime specifike. Duke shtuar kësaj, e drejta për të njohur origjinën gjenetike është gjithashtu një element i rëndësishëm në përcaktimin e identitetit të një personi i cili kishte të drejtë të merrte informacione përkatëse për të vërtetuar të vërtetën në lidhje me identitetin e prindërve të tij. njëra anë është aspekti mjekësor, i cili është shumë i rëndësishëm për të gjetur historinë mjekësore të të gjithë familjes dhe informacionin thelbësor mjekësor në lidhje me gjenetikën e dhuruesit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm që bie në sy është e drejta për të vendosur kontakte me dhuruesin ose vendosja e një marrëdhënie prindërore, një aspekt që sigurisht duhet të merret parasysh përmes prizmit të balancimit të të drejtave të dhuruesit dhe fëmijës, nëse të dy palët tregojnë një interes të përbashkët. Njohja e sfondit gjenetik është sigurisht shumë e rëndësishme për të parandaluar marrëdhëniet inçestuale midis të afërmeve që nuk e dinë se janë të lidhur gjenetiki. (Ignovska, 2016)

3.2. E drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij / saj e garantuar me dokumentet ndërkombëtare

Për të arritur standardet më të larta për mbrojtjen ligjore të të drejtave dhe lirive individuale, tendenca e legjislacionit modern është e orientuar drejt promovimit të mbrojtjes së

interesave më të mira të fëmijës. (Arta Selmani, 2017, f. 5) Ky parim sigurohet nga të gjitha rregulloret e brendshme ligjore si dhe dokumentet dhe konventat ndërkombëtare.

Sidoqoftë, angazhimi ligjor ndaj këtij parimi filloi të afirmohej me miratimin e KDF, një dokument që kodifikon të drejtat dhe interesat e fëmijëve, ndërsa i jep një rëndësi të madhe statusit të fëmijës si mbajtës i të drejtës. (Arta Selmani, 2017, f. 5)

Një nga dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që ka një ndikim të madh në legjislacion dhe një ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e fëmijës është Konventa e KB për të Drejtat e Fëmijëve. Duke njohur gamën më të gjerë të të drejtave të fëmijëve, ajo përfshin pothuajse të gjitha fushat e jetës së një fëmije. Një tipar veçanërisht i rëndësishëm i këtij dokumenti është se ai e trajton fëmijën si një entitet të veçantë, një qenie njerëzore autonome dhe individuale që ka të drejtat e tij të patjetërsueshme. (Micković R. , 2015)

Një nga shumë të drejta të rëndësishme të promovuara përmes kësaj Konvente është sigurisht e drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij. Sipas nenit 7 paragrafi 1 të Konventës: "Fëmija regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe do të ketë të drejtën për një emër, të drejtën e kujdesit, shtetësinë dhe, për aq sa është e mundur, të drejtën për të ditur se kush janë prindërit e tij".¹ dhe e drejta për kujdesin e tyre. Kjo dispozitë është gjithashtu e ndërlidhur me dispozitat e nenit 8², sipas të cilit: "Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij ose të saj, duke përfshirë kombësinë, emrin dhe lidhjet familjare siç njihen nga ligji, pa asnjë ndërhyrje ligjore. Në rast se një fëmijë privohet në mënyrë të paligjshme nga disa ose të gjithë elementët e identitetit të tij, Shtetet Palë do të sigurojnë ndihmën dhe mbrojtjen e duhur në mënyrë që identiteti i tij të rikthehet sa më shpejt të jetë e mundur."

E drejta e fëmijës për të ditur se kush janë prindërit e tij biologjikë është gjithashtu e parashikuar në Nenin 8 të KEDNJ-së.³ Ky artikull thekson se: "Një person ka të drejtë të respektojë jetën e tij private dhe familjare, shtëpinë dhe korrespondencën e tij. Autoriteti publik nuk duhet të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç nëse një ndërhyrje e tillë parashikohet me ligj dhe nëse është një masë në interes të shtetit dhe sigurisë publike, mirëqenien ekonomike të vendit, mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, mbrojtjen e

¹ KEDF (n.7)

² KEDF (n.8)

³ GJEDN (n.3)

"shëndeti dhe morali, ose mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, në një shoqëri demokratike". (Arta Selmani, 2017, f. 6) Kjo e drejtë e fëmijës garantohet gjithashtu nga Konventa për Birësimin e Fëmijëve të vitit 2007.⁴ Në këtë Konventë, si një parim themelor, natyrisht, fillon me mbrojtjen e të drejtës së fëmijës për të njohur origjinën e tij, dmth e drejta për të ditur se kush janë prindërit e tij (nëse është e mundur). Sidoqoftë, ky dokument thekson pozicionin e "pajtimit" të dy të drejtave, të cilat sipas Konventës janë plotësuese. Nga njëra anë, e drejta e prindërve biologjikë për të mos zbuluar identitetin e tyre dhe nga ana tjetër e drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij / saj. Sipas nenit 22 para. 3 "Fëmija i birësuar do të ketë qasje në të dhëna për origjinën e tij / saj, të dhëna të mbajtura nga autoritetet kompetente. Lidhur me të drejtën e prindërve biologjikë për të mos zbuluar identitetin e tyre, vendimi merret nga autoritetet kompetente, në mënyrë që në varësi të rregulloreve ligjore, ata të vendosin për zbulimin e identitetit të prindit, gjithmonë bazuar në rrethanat dhe të drejtat e fëmijës dhe prindërve biologjikë". Duke pasur parasysh të drejtën e personit për të njohur origjinën e tij / saj, të dhënat e rëndësishme në lidhje me birësimin do të mbahen nga autoritetet kompetente për të paktën pesëdhjetë (50) vjet nga vendimi për birësim. Shumë raste nga praktika tregojnë se të birësuarit fillojnë të kërkojnë prindërit e tyre biologjikë kur ata vetë bëhen prindër ose kur prindërit birësues nuk janë më gjallë. Sidoqoftë, Konventa thekson se e drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij ose të saj nuk duhet të kualifikohet si një e drejtë absolute, kështu që duhet të vendoset një ekuilibër midis të drejtës së fëmijës për të njohur origjinën e tij dhe të drejtës së prindërve biologjikë për të mbetur anonim. Sipas Konventës, kjo çështje thelbësore vendoset nga autoritetet kompetente. (Jakovac-Loziç, 2007, fv. 97-98)

Gjithashtu një dokument i rëndësishëm ndërkombëtar që garanton të drejtën për të njohur origjinën është Konventa e Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Fushën e Birësimit Ndërkombëtar (1993). Dispozita e Nenit 30 të kësaj Konvente detyron autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në rast të birësimit ndërkombëtar të sigurojnë mekanizma për ruajtjen e informacionit në lidhje me origjinën e fëmijës, në veçanti identitetin e prindërve të tij dhe historinë e tij mjekësore, si dhe të mundësojnë fëmija të ketë qasje në

⁴ Konventa për Birësimin e Fëmijëve, neni 22 paragrafi 3

informacion në lidhje me origjinën e tij. (Konventa e Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Fushën e Birësimit Ndërkombëtar , 2021)

Lidhur me testimin gjenetik për prindërimin e duhur për krijimin / sfidimin e amësisë / atësisë, duhet të shënohet edhe Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Dinjitetit të Qenies Njerëzore në lidhje me Zbatimin e Biologjisë dhe Mjekësisë.⁵ Një iniciativë tjetër e rëndësishme e ekspertëve evropianë në të drejtën e familjes është zhvillimi i parimeve që lidhen me vendosjen e prindërimit dhe pasojat e tij ligjore. Këto parime përfshihen në Librin e Bardhë mbi Parimet për Themelimin dhe Pasojat Ligjore të Prindërimit. Futet e drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij ose të saj si një nga parimet e përcaktuara në Librin e Bardhë. Sipas nenit 28 të Librit të Bardhë, interesi i fëmijës për të njohur origjinën e tij biologjike duhet të merret gjithmonë parasysh. (Arta Selmani, 2017, f. 7)

3.3. Rishikimi krahasues i të drejtës së fëmijës për të njohur origjinën e tij ose të saj

E drejta e fëmijës për të njohur origjinën e saj vite më parë theksohet si një e drejtë jetike dhe një e drejtë që duhet të respektohet, duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës. Në përgjithësi, kjo e drejtë e fëmijës nuk është aq e theksuar kur fëmija lind në një bashkësi martesore, sepse, që nga momenti i lindjes, dihen nëna dhe babai, përveç në rastet kur prindërimi ligjor dhe biologjik nuk përkojnë. Sidoqoftë, çështja e origjinës shqyrtohet nga fëmijët e paligjshëm, fëmijët e adoptuar dhe fëmijët e lindur përmes riprodhimit të asistuar biomedicinal. Nga ana tjetër, e drejta për anonimitet të dhuruesit në rast të fekondimit alogjenik (gamet ose embrionet e dhuruara) është me një të drejtë që fëmija të njohë origjinën e tij gjenetike dhe mënyrën e konceptimit të tij. (Clark, 2012, f. 43) Përplasja midis këtyre dy të drejtave është pjesë e viteve të diskutimeve dhe debateve shkencore.

Në vitet e fundit, një numër në rritje i vendeve kanë futur në legjislacionin e tyre konceptin e gjetjes së të vërtetës dhe të drejtës për të marrë informacionin përkatës në lidhje me origjinën gjenetike, i cili legjislacion ndahet në lidhje me kategorizimin e kësaj të drejte të fëmijës dhe të drejtës për anonimitet të prind / dhurues, gjë që shpjegohet më vonë në tekst. Historikisht, kjo e drejtë e fëmijës filloi të garantohej përmes dispozitave kushtetuese dhe

⁵ KEDNJ

ligjore kombëtare në fund të viteve 1980. Mbretëria e Bashkuar ka njohur të drejtën e fëmijës për të gjetur origjinën e saj tek fëmijët e adoptuar që nga viti 1975, dhe fëmijëve të lindur përmes VRT u është dhënë kjo e drejtë që nga viti 2005 (Amorós, Donor anonymity, or the right to know one's origins, 2015, f. 4). E rëndësishme është të theksohet fakti se shumë vende evropiane kanë miratuar politikën e filluar nga Suedia në 1984 dhe më pas Austria në 1992, e cila i jep mundësinë e informacionit të dhuruesve një personi të konceptuar përmes gametave të dhuruara kur ai arrin një moshë të caktuar. Kjo vlen edhe në Zvicër (me një ligj të vitit 1998, i cili është në fuqi që nga viti 2001), për fëmijët e birësuar nga 2002, duke e theksuar atë si një e drejtë absolute e fëmijës, Norvegjia në 2003, Holanda (me një ligj të 2002, në fuqi që nga 2004), Finlandë që nga 2006. (Amorós, Donor anonymity, or the right to know one's origins, 2015, f. 4)

Për legjislacionin modern, si dhe praktikën ligjore, siç u tha më lart, çështja se cila e drejtë e përparësisë vendoset në situata kur prindërit dëshirojnë të mbeten anonimë dhe kur kjo e drejtë është në kundërshtim me të drejtën e fëmijës për të njohur origjinën e saj është veçanërisht delikate. (Arta Selmani, 2017) Dëshira për (jo) prindërim në shumë raste është më e rëndësishme se e vërteta për origjinën. (Arta Selmani, 2017, f. 8) Prindëria në shumë situata bazohet në dëshirën e përbashkët të të dy partnerëve, kështu që në këtë kontekst dëshira për pasardhës i jepet përparësi mbi marrëdhënien biologjike. Ky aspekt shprehet veçanërisht në të drejtën për lindje anonime, përcaktimin dhe sfidën e atësisë jashtëmartesore, metodat e ndryshme të riprodhimit të asistuar biomjekësor, disa situata të birësimit. Për shkak të kësaj, duke marrë parasysh përvojat krahasuese ligjore, varësisht nga mënyra se si ata e kategorizojnë këtë të drejtë të fëmijës dhe dhuruesit, spikasin disa vende:

Legjislacioni që garanton anonimitetin absolut të dhuruesit të materialit gjenetik dhe që përjashton çdo përgjegjësi të dhuruesit ndaj fëmijës së lindur. Ky sistem është i pranuar nga legjislacioni francez, i cili siguron jo vetëm anonimitetin e dhuruesit, por gjithashtu garanton që vendosja e marrëdhënies prindërore midis dhuruesit dhe fëmijës së lindur përmes VRT nuk mund të kërkohet, dmth. statusi i atësisë ose amësisë së dhuruesit mund të mos jetë i nevojshëm. Duhet gjithashtu të theksohet se ligji francez garanton të drejtën e nënës që të mbetet anonime gjatë lindjes së fëmijës dhe të mos regjistrohet në regjistrin e lindjeve si nënë

e fëmijës. Përveç Francës, e drejta e nënave për të lindur në mënyrë anonime është e garantuar në Republikën Çeke, Itali dhe Luksemburg.

Shtetet që përmes ligjeve të tyre sigurojnë një anonimitet të përgjithshëm dhe relativ të dhuruesit. (Arta Selmani, 2017, f. 9) Në Spanjë, për shembull, është e lejueshme që një fëmijë të informohet për dhuruesin, por jo për identitetin e tij dhe të saj, dhe vetëm në rastet kur ai lloj informacioni është i nevojshëm për shëndetin e fëmijës. Informacioni i identitetit gjithashtu mund të zbulohet kur kërkohet nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Për më tepër, Kodi Civil i Kebekut ua jep këtë të drejtë pasardhësve

Legjislacioni nën të cilin mund të merren informacionet e identitetit të donatorëve, por nuk imponon përgjegjësi prindërore. Sipas ligjit suedez, kjo e drejtë i përket fëmijës nga mosha madhore, dhe sipas ligjit austriak, pas moshës 14 vjeç.

Legjislacioni që njeh të drejtën e fëmijës për të gjetur identitetin e dhuruesit, por edhe të drejtën për të filluar një procedurë për të vendosur atësinë e dhuruesit. Kjo e drejtë nuk pranohet si e drejtë absolute, por vetëm në situata kur atësia e burrit të nënës me të cilën fëmija jeton nuk mund të përcaktohet.

Siç mund të shihet, legjislacioni në Evropë është i ndarë në lidhje me këtë të drejtë të fëmijës dhe të drejtën e anonimitetit të dhuruesit. Kjo do të thotë që e drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij ose të saj në klimën evropiane nuk ka karakterin e një norme të domosdoshme, që do të thotë se në disa situata kjo e drejtë mund të kufizohet ose realizimi i saj mund të jetë i pamundur. (Arta Selmani, 2017, f. 9) Pra, përmbushja e kësaj të drejte të fëmijëve sigurisht që mund të mundësohet "për aq sa është e mundur", për sa kohë që nuk është e rrezikuar e drejta e prindërve që kanë vendosur të mbeten anonimë (kur pranojnë birësimin ose kur dhurojnë një vezë ose spermë në rast të mbarësimin artificial). Por, duke marrë parasysh të drejtat dhe interesat e prindërve ose dhuruesit, koncepti dominues duhet të jetë interesi më i mirë i fëmijës. E drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij ose të saj duhet të trajtohet si një e drejtë absolute dhe themelore e njeriut. (Arta Selmani, 2017, f. 9) Vetëm në këtë mënyrë fëmija do të faktorizohet si një subjekt real i ligjit që është një kërkesë themelore e KDF.

3.4. Kuadri ligjor dhe kontradiktat në legjislacionin maqedonas lidhur me të drejtën për të njohur origjinën

Legjislacioni familjar i vendit tonë thekson se, pas vendosjes së birësimit të plotë në regjistrin e lindjeve, prindërit adoptues regjistrohen si prindër të fëmijës, dhe vendi i lindjes së fëmijës është vendi që do të përcaktohet nga prindërit adoptues. Prindërit birësues konsiderohen prindërit e të birësuarit që nga momenti i lindjes së tij. Nga ana tjetër, me vetë faktin se të dhënat për birësimet e bazuara janë një sekret zyrtar (neni 123-a, LF), fëmija pengohet të marrë të dhëna për prindërit e tij biologjikë. Nga perspektiva e mbrojtjes së të drejtave, Ligji për Familjen mbron të drejtën për anonimitet të prindërve biologjikë dhe faktin e birësimit, dmth u jep përparësi të drejtave të prindërve. (Arta Selmani, 2017, f. 10) Me këtë, Ligji ynë nuk mbron të drejtën e fëmijës së birësuar për të gjetur të dhënat në lidhje me prindërit e tyre biologjikë të garantuara nga neni 7 paragrafi 1 i KDF. Kjo dispozitë ligjore është gjithashtu në kundërshtim me nenin 22 paragrafi 3 të Konventës Evropiane për Adoptimin e Fëmijëve, e cila garanton të drejtën e fëmijës për të pasur akses në informacionin për origjinën e tij / saj. Kjo e drejtë është e kufizuar edhe për fëmijët e adoptuar duke mos i lejuar ata të vendosin atësinë ose amësinë, një koncept që sigurisht meriton kritikë të veçantë.

Sipas legjislacionit familjar, personi i birësuar nuk ka të drejtë për një marrëdhënie të vërtetë shoqërore me prindërit biologjikë, e drejta e tij për të marrë kujdes dhe prindërim është përmbushur nga prindërit adoptues, kështu që këtu e drejta e tij është ezauruar. (Ignovska, 2016) Sidoqoftë, atij duhet t'i mohohen informacionet që i duhen për të marrë një pamje të qëndrueshme të origjinës së tij dhe një shpjegim se si ai erdhi në këtë botë. Nga ana tjetër, prindërit birësues nuk kanë asnjë detyrim ligjor t'i sigurojnë fëmijës informacion në lidhje me birësimin dhe origjinën e tij. Por praktika tregon se fëmija pas një periudhe të caktuar kohe, ende mëson të vërtetën për prindërit e tij biologjikë.

Kur bëhet fjalë për fëmijët e konceptuar përmes riprodhimit të asistuar biomjekësor, është gjithashtu problematike që informacioni në lidhje me origjinën e dhuruesit konsiderohet sekret i klasifikuar, në kundërshtim me nenin 7 të KDF, i cili i garanton fëmijës të drejtën të dijë se kush janë prindërit e tij ose të saj. Kjo e drejtë nënvizohet gjithashtu në nenin 8 të KEDNJ-së dhe interpretohet në kuptim të respektimit të jetës private dhe familjare të fëmijës. Lidhur me

këtë çështje, dispozitat e Ligjit për Familjen, si dhe dispozitat e Ligjit të mëparshëm dhe Ligjit të ndryshuar për Fekondimin e Ndhimuar Biomjekësisht (LFNB) gjithashtu nuk pajtohen. Gjegjësisht, në ndryshimet në LFLA, nga njëra anë, në rast të zëvendësimit, lejohet të informohet për të dhënat për bartësin gestacional dhe mënyrën e konceptimit dhe lindjes së fëmijës pasi të ketë mbushur moshën pesë vjeç (neni 12-c), ndërsa, nga ana tjetër, institucionet e autorizuara shëndetësore janë të detyruara të "sigurojnë mbrojtjen e të gjitha të dhënave personale, mjekësore dhe gjenetike për transportuesin gestacional, çiftin e martuar dhe fëmijën". (Arta Selmani, 2017, f. 12) Dispozitat e tilla janë më shumë se konfuze konceptuale, veçanërisht duke pasur parasysh traditën e gjatë ligjore të "mbajtjes së sekreteve" në fushën e "mbarësimit artificial" dhe birësimit në Republikën e Maqedonisë Veriore, e cila në vetvete meriton kritika. Në këtë drejtim, një nga bankat më të famshme të spermës në botë - danez "Krios" (nga i cili importojnë shumica e vendeve në Evropë, përfshirë Republikën e Maqedonisë), njofton me kujdes në faqen e saj zyrtare: "Ne kemi një marrëveshje me palët (donatorë dhe ata që duan të jenë prindër), por ne nuk kemi arritur një marrëveshje me fëmijët e ardhshëm dhe nuk mund të ndikojmë në sjelljen e tyre, kërkesat dhe nevojat e tyre".

Duke u nisur nga fakti se e vërteta gjithmonë zbulohet, është e nevojshme që ky Ligj të rregullohet në Ligjin e Familjes, përmes ndryshimeve specifike ligjore që do të rrënjosin respekt për identitetin personal të fëmijës.

3.5 Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen e të drejtës së identitetit personal

Në lidhje me dokumentet e tjera ndërkombëtare, KDF garanton, midis të drejtave të tjera, të drejtën për të gjetur origjinën dhe ndryshon në atë që përmban një sistem të veçantë të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. (Дејан Мицковиќ, 2015, f. 212) Sidoqoftë, duke qenë se nuk ka mundësi që një shtet që ka shkelur të drejtën e një fëmije të paditet ndërkombëtarisht, KDF -së i mungon mbrojtja efektive ligjore. Përveç CRC, të drejtat e fëmijës rregullohen nga Konventa për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve, Konventa për Kontaktin e Fëmijëve dhe një sërë instrumentesh të tjerë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, dispozitat e të cilave mund të zbatohen për fëmijët. Nga këto dokumente, KEDNJ është më e rëndësishmja sepse Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendos për shkeljet e të drejtave të mbrojtura nga kjo

Konventë. Në praktikën e saj të deritanishme, Gjykata mundëson mbrojtjen jo vetëm të të drejtave dhe interesave të fëmijës të siguruar nga KEDNJ, por gjithashtu indirekt mundëson mbrojtjen e të drejtave të parashikuara në Konventën e OKB për të Drejtat e Fëmijëve. (Arta Selmani, 2017, f. 13) KDF si instrumenti më i rëndësishëm ligjor ndërkombëtar, i cili mbron të drejtat e fëmijës, është një dokument, dispozitat e të cilit i referohen GJEDNJ-së, si dhe Komitetit të KB për të Drejtat e Njeriut.

Rastet e paraqitura në GJEDNJ për mbrojtjen e të drejtës së identitetit personal i referohen saktësisht dispozitave të nenit 8 të KEDNJ-së. Gjegjësisht, shumë raste në lidhje me vendosjen ose diskutimin e origjinës janë shqyrtuar para GJEDNJ-së, në mënyrë që të informohen fëmijët për prindërit e tyre biologjik me qëllim që të zbulohet origjina. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka vendosur mbi të miturit nën kujdestarinë e administratës publike dhe fëmijët e adoptuar si është rasti i (Odièvre k. Francës, 13.2.2003 dhe Godelli k. Italisë, 25.9.2012), dhe justifikojnë prejardhjen e veprimeve dhe pretendimeve për atësinë jo-martësore (Mikulic k. Kroaci, 7.2.2002), edhe përtej parashkrimit të këtyre veprimeve përcaktuar nga ligjet kombëtare (Jäggi k. Zvicrës, 13.7.2006 dhe Backlund kundër Finlandës, 6.7.2010) Bazuar në të gjitha këto raste, mund të konkludojmë se e drejta për të njohur origjinën e dikujt është një e drejtë thelbësore në zhvillimin e një individi identiteti, i cili jo domosdoshmërisht duhet të zhvillohet drejt një lidhje ligjore të prindërimi me fëmijët, dhe që është pjesë e së drejtës për jetën private e njohur në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). (Amorós, Anonimiteti i donatorit, apo e drejta për të njohur origjinin e tij?, 2015, f. 7).

Në rastet aktuale të çështjes së GJEDNJ, gjykata merr mendimin se neni 8 i KEDNJ garanton të drejtën për një identitet personal. Detajet e identitetit të një individi dhe interesi për të gjetur informacionin e nevojshëm për të gjetur të vërtetën në lidhje me aspektet e rëndësishme të identitetit personal, siç është identiteti i prindit (çështja Odivere kundër Francës), luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin personal. Lindja dhe rrethanat e lindjes janë elemente thelbësore të jetës private të fëmijës. "Informacioni në lidhje me aspektet personale të fëmijërisë, zhvillimit dhe së kaluarës mund të shërbejë si burimi kryesor i informacionit në lidhje me historinë e jetës personale" (Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar), kështu që mohimi i qasjes së një fëmije në atë informacion përkatës përbën heqje nga e drejta

për të gjetur identitetin e tij personal të garantuar nga neni 8 i KEDNJ-së. Gjithashtu, përfundimi i pranuar në të drejtën ndërkombëtare është se neni 8 garanton mbrojtjen e së drejtës për kujdestari të identitetit të fëmijës. Ky nen ofron mbrojtje nga ndërhyrjet e paligjshme në identitetin personal, duke përfshirë shtetësinë, emrin dhe lidhjet familjare. Si përfundim, ky artikull garanton ndihmë dhe mbrojtje adekuate kur fëmija privohet në mënyrë të paligjshme nga elementet thelbësore të identitetit të tij për të mundësuar rivendosjen e tij.

Kapitulli IV

4.1. E drejta e fëmijëve për të njohur prindërit e tyre biologjik

E drejta për të njohur origjinën do të thotë e drejta për të njohur prindërinë, d.m.th. familjen biologjike dhe ngjitjen e tij dhe kushtet e lindjes. Në planin ndërkombëtar, kjo e drejtë perceptohet gjerësisht si e Drejta për të Ditur - dhe konsiderohet si një pjesë integrale e së Drejtës për Jetë dhe E Drejta e Privatësisë. Mbron interesin e secilit individ për të identifikuar se nga vjen. Interesi i fëmijëve për të njohur origjinën e tij zakonisht konsiderohet si mjaft themelor ose 'jetësor'. Në të vërtetë vlerësohet si një element i rëndësishëm në ekuilibrin psikologjik të fëmijëve për të ditur se nga vjen. (Amorós, Anonimiteti i donatorit, apo e drejta për të njohur origjinën e tij?, 2015, f. 5)

Secili prej nesh ka të drejtë për të vërtetën në lidhje me origjinën e vet. Për më tepër, fëmijët e adoptuar ose të lindur nga metodat teknologjike-artificiale me donator, të cilët varen nga vullneti i mirë i autoriteteve ose prindërve të tyre socialë për të ditur për origjinën e tyre, vuajnë nga diskriminimi në krahasim me fëmijët prindërit socialë dhe gjenetikë të të cilëve përputhen, por edhe me fëmijët e tjerë prindërit socialë dhe biologjikë të të cilëve ndryshojnë. Interesat e mëtejshme ndihmëse përfshijnë interesin për të njohur historinë mjekësore të dikujt dhe interesin për të konstatuar të drejtat ligjore siç është e drejta e trashëgimisë.

Rëndësia e interesave të mbrojtura nga e drejta për të njohur origjinën e dikujt nuk zvogëlohet me moshën. Si pasojë, bartësit e të drejtës për të njohur origjinën e dikujt janë fëmijët po aq sa të rriturit. Kërkimi i origjinës së dikujt është me të vërtetë pjesë e kërkimit të identitetit dhe e drejta për të ditur mbron një interes që është po aq jetësor për një fëmijë, sa është për një të rritur. (Kothari, f. 8)

Nevoja për të njohur prindërimin dhe prejardhjen e dikujt është thelbësore për fëmijët dhe të rriturit që nuk e kanë këtë informacion. Kjo e drejtë për të njohur origjinën e dikujt do të thotë të kesh informacionin dhe identitetin e prindërve biologjikë dhe kushtet e lindjes. E drejta për të njohur buron nga dëshira për të njohur identitetin e vetvetes. Shkencëtarët socialë kanë konsideruar që kuptimi i identitetit të përcaktohet nga tre aspekte kryesore: vetëvendosja, koherenca e personalitetit dhe ndjenja e vazhdimësisë me kalimin e kohës. Identiteti shihet kështu si në thelb "vetë-në-kontekst". Kjo do të thotë që identiteti shpesh përcaktohet nga ndryshimet shoqërore dhe përkufizimi i dikujt për veten ndikohet nga mënyra se si një marrëdhënie shihet në kontekstin shoqëror. (H D. Grotevant, 2000, fv. 379-387)

Sigurisht, në praktikë, mjetet aktuale për të mbrojtur interesin e fëmijës për të njohur ndryshojnë nga ato për të mbrojtur të drejtën e një të rrituri. Fëmijët janë zakonisht më emocionalë dhe më pak të pjekur dhe mund të destabilizohen më lehtë nga informacione të caktuara. Prandaj, praktikat ndryshojnë nga një shtet në tjetrin. Ndërsa në shumicën e shteteve evropiane, fëmijët kanë qasje vetëm në të dhënat e tyre gjenetike pasi të jenë tetëmbëdhjetë, shtetet e tjera sigurojnë një qasje të menjëhershme në këto të dhëna. Në çdo rast, lëshimi i informacionit për fëmijët e vegjël zakonisht kontrollohet me kujdes në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës. Fëmijët që kërkojnë informacion mbi identitetin e prindërve të tyre biologjikë, e artikulojnë këtë nevojë si të drejtë të njohin origjinën e tyre.

Bartësi kryesor i detyrës së fëmijës për të njohur origjinën e saj është Shteti. Shteti duhet kryesisht të përmbahet nga ndërhyrja në të drejtën e fëmijës për të ditur. Ai gjithashtu ka mjete dhe detyrën për të rregulluar regjistrimin në lindje dhe për mbledhjen dhe mbylljen e të gjitha të dhënave përkatëse që kanë të bëjnë me identitetin e një personi. Për më tepër, zakonisht është shteti që vendos detyrime ligjore sipas ligjit kombëtar mbi individë si nëna për të identifikuar babanë ose për të siguruar identifikimin e saj, por gjithashtu që përcakton sanksione ligjore kundër atyre që shkelin ato detyra horizontale.

4.1.1 E drejta negative për të njohur origjinën e dikujt / e drejta pozitive për të njohur origjinën e dikujt

E drejta për të njohur origjinën e dikujt zakonisht garantohet si një e drejtë negative që mbron interesat e dikujt kundër shkeljeve aktive nga autoritetet shtetërore, por gjithashtu - dhe që është më e rëndësishmja duke pasur parasysh rëndësinë e regjistrimit, ruajtjes dhe hapjes së qasjes në të dhënat e lindjes - si një e drejtë pozitive që mbron nga një lëshim pasiv i shtetit. Kjo pranohet nga garancitë kombëtare dhe ndërkombëtare të së drejtës që mbrojnë dimensionet e saj negative dhe pozitive. Kështu, neni 8 i KEDNJ-së nënkupton detyrat për të regjistruar dhe më pas për të ruajtur të dhënat dhe për t'i bërë ato të arritshme për fëmijën.

Neni 7 i KDF-së e bën këtë edhe më preciz në atë që garanton të drejtën pozitive të regjistrimit gjatë lindjes dhe të drejtën pozitive për ruajtjen e këtyre të dhënave për konsultime të mëvonshme. Kur babai është i panjohur, autoritetet shtetërore kanë për detyrë të kërkojnë identifikimin e tij. Neni 8 para 2 KDF-së gjithashtu thekson detyrat pozitive të ndihmës dhe mbrojtjes për të rivendosur me shpejtësi mundësinë që një fëmijë të ruajë identitetin e saj.

Të njëjtat detyra të regjistrimit dhe ruajtjes mund të rrjedhin edhe nga neni 24 i KEDNJ-së. Sigurisht, fusha e detyrave pozitive dhe intensiteti i tyre është më e vështirë të paracaktohet sesa ato të detyrave negative. Si rezultat, marzhi i vlerësimit të autoriteteve kombëtare është më i gjerë. Neni 8 para 1 KDF-së, për shembull, u referohet shteteve "duke marrë për të ruajtur" identitetin e fëmijës dhe neni 8 paragrafi 2 KDF-së kërkon masa "të përshtatshme" për të rivendosur identitetin e fëmijës.

4.2 E drejta e anonimitetit të prindërve biologjikë dhe donatorëve

Kur një nënë pas lindjes, vendos që fëmijën e saj biologjik të japë për adoptim, ajo mund të zgjedhë të mbetet anonime, mund të zgjedhë të mbetet në jetën e fëmijës përmes adoptimit jo te plotë ose ajo mund të zgjedhë të sigurojë ligjërisht që fëmija mund ta gjejë atë vetëm nëse ajo dëshiron ta bëjë këtë. Sidoqoftë, këto zgjedhje nuk janë gjithmonë të vendosura në duart e fëmijëve, për shkak se shumë vende nuk lejojnë që ata të njohin identitetin e prindërve të tyre biologjikë.

Në vendin tonë çështja e anonimitetit të prindërve biologjik rregullohet me LF ku në mënyrë kategorike nuk lejon që fëmija të marrë informacione për prindërit e tij biologjik ku në nenin 123-a thuhet se “Të dhënat për themelimin e adoptimit janë sekret zyrtarë”, që nënkupton se institucionet përkatëse, përkatësisht Qendra për punë sociale ka për detyrë që informacionet për prindërit biologjikë të të adoptuarve ti mbajnë sekret.

Mirëpo edhe përkundër faktit se ligji në vendin tonë nuk e lejon që fëmijët të marrin informacion për prindërit e tyre biologjik, kemi shumë fëmijë të cilët dëshirojnë që të dinë prejardhjen e tyre të cilët drejtohen te Qendra për punë sociale për të marrë informacion, mirëpo QPS nuk u jep informacion për shkak se nuk ua lejon ligji.

Disa studime kanë treguar tashmë se fëmijët e konceptuar nga 'riprodhimi i asistuar' shkojnë shumë mirë në kriteret e matura personale dhe sociale, kur krahasohen me fëmijët e konceptuar 'natyrshëm' ose të birësuar, por studime të tilla kanë të bëjnë me shembuj të familjeve ku shumica e prindërve kanë zgjedhur të mbështesin anonimitetin dhe fshehtësinë në dhurimin e gametave. Ekzistojnë nivele të shumta të fshehtësisë dhe zbulimit në botën e dhuruesve. Së pari, shumë pasardhës të konceptuar nga donatorë thjesht nuk e dinë se janë të konceptuar nga donatorë. Një nivel i dytë ka të bëjë me shtresat e fshehtësisë midis pasardhësve, dhuruesve dhe prindërve që kanë përdorur gamet e dhuruesve. Sekretin që përshkon këtë botë është produkt i normave dhe kontratave kulturore, jo i parimeve kushtetuese ose vendimmarrjes legislative. Ndërsa dhuruesit dhe prindërit mund të kenë nënshkruar marrëveshje që kanë të bëjnë me anonimitetin, shumë pak mendime të gjykatës kanë interpretuar vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e këtyre dokumenteve. (Amorós, Donor anonymity, or the right to know one's origins, 2015, f. 6)

Në fund të fundit, ata që janë në favor të rregullit të anonimitetit e kundërshtojnë faktin se shumë njerëz që nuk e kanë këtë informacion kanë një identitet të kufizuar qartë dhe se dhënia e një rëndësie të madhe për gjenetikën nuk është mënyra më e mirë për të garantuar mirëqenien e familjeve që nuk ndajnë të njëjtën përbërje gjenetike.

Një nga kundërshtimet më të shpeshta për të drejtën që fëmijët e konceptuar me gamet e dhuruara të dinë origjinën e tyre është se kjo bie ndesh me të drejtën e dhuruesit për privatësi. Sidoqoftë, në riprodhimin artificial, ndryshe nga riprodhimi seksual, ndërhyrja e njerëzve jashtë procesit riprodhues për të bërë të mundur ngjizjen prish rregullin e anonimitetit që nga fillimi. (F.Shenfield, 1997, f. 393)

Megjithatë, në këtë konflikt të të drejtave, e drejta e fëmijës duhet të mbizotërojë, pasi që edhe pse informacioni mjekësor është konfidencial, çështja zhvendoset sapo të lindë një person. Lidhur me argumentin se heqja e anonimitetit të donatorëve mund të shkelë të drejtën për riprodhim pasi që mund të ulë numrin e dhurimeve, përveç faktit se nuk ka prova empirike për të mbështetur këtë pretendim, një politikë më transparente do të ndikonte vetëm në riprodhimin artificial. Për më tepër, në fund të fundit një sistem në të cilin donatori vendos nëse ata dëshirojnë të identifikohen apo jo do të vazhdojë të respektojë të gjitha të drejtat e përfshira. (Amorós, Anonimiteti i donatorit, apo e drejta për të njohur origjinin e tij?, 2015, f. 7)

Rekomandimet

Metodat teknologjike-artificiale për lindjen e fëmijës kohës së fundit janë duke u vënë në zbatim në masë të madhe, ku numri i rasteve të lindjes së fëmijëve me anë të përdorimit të këtyre metodave është në rritje çdo ditë e më shumë. Mirëpo është në dilemë fakti sesi do ndikojnë këto metoda teknologjike-artificiale në shoqërinë tonë dhe sa i pranueshëm do jetë fakti që rëndësi duhet ti kushtohet interesit të fëmijës në ato raste që fëmija duhet të përballohet me të vërtetën e prejardhjes së tij.

Interesi i fëmijës për të njohur prejardhjen e tij biologjike duhet të jetë prioritet dhe duhet të respektohet në raport me anonimitetin e donatorit, pa marrë parasysh se si ka ardhur deri te lindja e fëmijës (insiminimi artificial apo invitro fertilizmi).

Arsyeja qëndron në atë se donatori me vetëdije, vetëiniciativë dhe vetëdëshirë pranon që të dhurojë matrijalin e tij gjenetik për ngjizjen e fetusit, me qëllim të lindjes së fëmijës. Në bazë të Ligjit për insiminim të asistuar biomedicinal, “Institucionet shëndetësore të autorizuara janë të detyruara të sigurojnë mbrojtjen e të gjitha të dhënave personale, mjekësore dhe gjenetike për dhuruesin dhe marrësin dhe të marrin masat e nevojshme në mënyrë që të mos zbulojnë identitetin e marrësit të dhuruesit dhe familjes së tij dhe anasjelltas”, ku nga njëra anë paraqet mbrojtje të donatorit kurse nga ana tjetër e cënon të drejtën e fëmijës për të ditur të vërtetën e prejardhjes së tij.

Nga njëra anë Ligji i lartpërmendur bie ndesh me Konventen Evropiane për të drejtat e fëmijëve i cili thotë “Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.”.

Nga ky këndvështrim si mund të respektohet e drejta e donatorit i cili me vetëdije ka kontribuar në lindjen e fëmijës dhe i cili është dashur të marrë parasysh faktin që në të ardhmen fëmija i lindur nga materiali gjenetik i tij mund të shfaqë interes për të njohur prejardhjen e tij të vërtetë, apo e drejta absolute për të qenë prind e personave që pranojnë të kenë fëmijë me anë të këtyre metodave pa mos e menduar se si do të ndikonte në jetën fëmijës së lindur me anë të këtyre metodave. Këto rrethana duhet marrë parasysh si nga ana e donatorve ashtu edhe nga ana e prindërve të fëmijës, sepse kjo situatë mund të ketë ndikim thelbësor në formimin personal dhe psikologjik të fëmijës, për vetë faktin se natyra dhe

personaliteti i fëmijëve është i ndryshëm dhe jo çdo njëri mund ta pranojë në mënyrën më të mirë të mundshme faktin se lindja e tij është bërë me metoda teknologjike-artificiale. Varësisht nga natyra e fëmijës, ai mund të ndjehet i përulur, nënvlersuar apo i dalluar nga rrethi social i cili fakt paraqet edhe një lloj diskriminimi për këta fëmijë.

Për formimin e familjes përveç metodave teknologjike-artificiale është edhe instituti i adoptimit i cili poashtu është prezent në shoqërinë tonë. Njëjtë si tek rastet me anë të metodave teknologjike-artificiale të lartpërmendura, është akoma kontestues fakti se a duhet të respektohet më shumë interesi i fëmijës së adoptuar apo anonimiteti i prindërve biologjik, i cili edhe në këtë rast është i mbrojtur me dispozita ligjore por për dallim nga anonimiteti i donatorve që mbrohet nga Ligji për insiminim të asistuar biomedicinal, anonimiteti i prindërve biologjik mbrohet nga Ligji për familje, i cili njëjtë si Ligji për insiminim të asistuar biomedicinal bien ndesh me Konventën Evropiane për të drejtat e fëmijës.

Edhe për kundër faktit që identiteti i tyre mbrohet me dispozita ligjore, nuk duhet të injorohet dhe të lihet mënjanë interesi i fëmijës i cili poashtu gëzon të drejtën e njohjes së prejardhjes së tij të vërtetë në bazë të Konventës për të drejtat e fëmijëve e cila është e ratifikuar nga vendi jonë.

Duke marrë parasysh të gjithë këto rrethana, si dhe pyetsorit të cilin e kam realizuar gjatë hulumtimit të këtij punimi, mund të konstatojmë se shumica e anketuesve ishin pro interesit të fëmijëve dhe në raport me anonimitetin duhet të jetë më i respektueshëm. Vetë fakti se vendi jonë ka ratifikuar Konventën evropiane për të drejtat e fëmijës, legjislacioni në vendin tonë duhet që të përputhet me konventën dhe të lejojë që fëmijët e lindur nga metodat teknologjike-artificiale si dhe fëmijët e adoptuar të kenë të drejtën që të marrin informacion për prejardhjen e tyre të vërtetë, duke shtuar një dispozitë ligjore ku parimi Interesi i fëmijës për të njohur prejardhjen e tyre biologjike të jetë primare.

Përfundimi

Fëmijët janë qënia më e ndjeshme dhe delikate, dhe kjo tematikë është mjaftë e gjërë. Është e vërtetë që ata gëzojnë kujdes dhe mbrojtje institucionale, të parapara me konventa dhe dispozita të ndryshme ligjore, mirëpo ka ngelur gjithmonë si pikëpyetje se: “A janë në zbatim të njejtat apo egzistojnë vetëm në mënyrë figurative?!” – për këtë ka mendime dhe fakte të ndryshme prandaj do ishte mire që të sigurohen sa më shumë të dhëna, informata dhe statistika lidhur me gjithë këtë, me qëllim që e njejta të jetë sa më transparente për vetë individët.

Duke pasur parasysh faktin se fëmijët duhet të kenë formim të duhur personal, të kenë zhvillim intelektual dhe të jenë gjithmonë të kompletuar në çdo aspekt dhe të përgatitur për avansime tjera të mundshme gjatë rrugëtimit të tyre, duhet treguar kujdes të veçantë dhe maksimal për mirëqenien e tyre sociale dhe psikologjike. Kjo vlen për të gjithë fëmijët në përgjithësi, por duke pasur parasysh faktin se jo të gjithë fëmijët lindin apo rriten dhe zhvillohen në mënyrë të barabartë është në dilemë si funksionon përkujdesja ndaj tyre në rastet kur kemi jobarazi dhe dallime mes tyre, të cilën e kam parashtruar brenda hulumtimit.

Gjatë këtij hulumtimi vërehet qartë se në shoqërinë tonë edhe më gjerë nuk respektohet shumë interesi i fëmijëve, më konkretisht interesi i fëmijëve për të njohur prejardhjen e tyre biologjike e cila është edhe temë kryesore në këtë punim, dhe e njejta për vetë faktin se bëhet një lloj dallimi mes fëmijëve që lindin në mënyrë natyrore në raport me fëmijët që lindin me metoda artificiale-teknologjike, apo fëmijët e adoptuar.

Lidhur me këtë mendoj që nuk është e drejtë që fëmijëve në përgjithësi pa marrë parasysh mënyrën e lindjes së tyre t’u mohohet dhe në një farë mënyre t’u ndalohet e drejta për të njohur prejardhjen e tyre të vërtetë, por t’u lejohet që të dinë prejardhjen e tyre dhe tu lihet në dorë atyre që të vendosin nëqoftë se dëshirojnë apo jo të bien në kontakt me personat që kanë kontribuar në lindjen e tyre, qoftë donator apo prindërit biologjik të cilët i kanë lënë në adoptim.

Gjithashtu duhet t’i kushtohet më shumë rëndësi interesit personal të fëmijës i cili duhet të jetë i informuar për mënyrën e ardhjes së tij në jetë dhe të njejtin fakt ta pranojë në një mënyrë më të lehtë dhe më të mirë të mundshme, pa mos i’u cënuar ndonjë e drejtë dhe pa pasur ndikime negative.

Përveç kësaj për mirëqenien sociale dhe psikologjike të fëmijëve në përgjithësi, është mirë që individët në bashkëpunim me institucionet shtetërore duhet të angazhohen më shumë për mirëinformimin e shoqërisë duke organizuar kështu aktivitete të ndryshme me qëllim që të sjellin informata tek individët më saktësishtë tek fëmijët ku në rast se ndonjëri prej tyre është i lindur nga mënyrat e lartpërmendura të jetë i informuar për të drejtat dhe mbrojtjen ligjore-institucionale që gëzon, si dhe të dijë se ku të drejtohet për të paraqitur interesin e tij që të kuptojë të vërtetën e prejardhjes së tij.

Të njëjtët duhet të jenë të përkrahur dhe të mbështetur nga shoqëria si dhe të pranohen në shoqëri pa mos u ndjer të diskriminuar apo të dalluar nga fëmijët që janë të lindur nga mënyrë natyrore apo nga ata që janë të lindur dhe rritur nga prindër biologjik.

Duke qenë se studimet në këtë fushë, në vendin tonë janë të pakta, për të mos thënë se nuk ekzistojnë fare lidhur interesin e fëmijës për të njohur prejardhjen e tij vendi, dhe duke u nisur pastaj nga mënyra se si është strukturuar ky punim, vërehet se lexuesit do ti shërbejë në informimin e saktë rreth mënyrës së sigurimit të informacioneve për të njohur mënyrën dhe prejardhjen biologjike të fëmijëve dhe me ç'rast do të kontribuojnë në respektimin e interesit më të lartë të fëmijës, gjegjësishtë interesit të fëmijëve për të njohur prejardhjen tyre të vërtetë.

Literatura

- Arthur Caplan, Janna Merrick, and Robert H. Blank, *Human Reproduction, Emerging Technologies, and Conflicting Rights*, Congressional Quarterly Press, 1995
- Andrzejczak-Świątek M, 'The right of the child to know his or her parents' in Bronisław Sitek, Jakub J. Szczerbowski, Aleksander W. Bauknecht (eds), *The Rights to Knowledge and Information in a Heterogenic Society* (Cambridge Scholars Publishing, 2009)
- Besson S, 'Enforcing the Child's Right to Know Her Origins: Contrasting Approaches Under the Convention on the Rights of the Child and the European Convention on Human Rights' (*International Journal of Law Policy and the Family* 21(2) 2007)
- Clark B, 'A balancing act? The rights of donor-conceived children to know their biological origins' (*Georgia journal of international and comparative law*, Vol.40 No.3, 2012)
- Corral H, 'Filiation and assisted reproductive technology' (*Revue Générale de Droit U. de Ottawa*, No. 31, 2001)
- Farnós Amorós E, 'Donor anonymity, or the right to know one's origins?' (*Butlletí del Comitè de Bioètica de Catalunya* 15, 2015)
- Galić Ž, 'Pravo na saznanje podrijetla i najbolji interes djeteta' (Zbornik radova Drugi međunarodni naučni skup 'Najbolji interes djeteta u zakonodavstvu i praksi' Dani porodičnog prava Mostar 2013)
- Hlača N, 'Pravo majke na anonimnost poroda – »l'accouchement sous x – porod pod x«' (*Gynaecologia et Perinatologia*, Zagreb, Vol.16 No. 3, 2007)
- Hrabar D, 'Deontološka prosudba ljudskog dostojanstva u obiteljskom pravu' *Bogoslovska Smotra Zagreb* Vol.77 No.1, 2007)
- Мицковиќ Д, Ристов А, *Семејно право* (Стоби Трејд, Скопје, 2015)
- Ravitsky V, 'The right to know one's genetic origins and cross-border medically assisted reproduction' (*Israel Journal of Health Policy Research* 6:3, 2017)
- Selmani-Bakiu A, Zendeli E, 'The Parenting Responsibility in the context of the Convention on the Rights of the Child and protection before the European Court of Human Rights' (*Balkan Social Science Review*, Vol.8 No.8, 2016)
- Закон за семејството на РМ, Консолидиран текст, ноември 2015 год.
- Alexander Sanger, *Beyond Choice: Reproductive Freedom in the 21st Century*, PublicAffairs, 2004
- Barbara Stark. *International Family Law- An Introduction*, Burlington, Ashgate Publishing Company, 2005
- Baarsma, N. A, *The Europeanisation of International Family Law*, The Hague, T.M.C. Asser Press, 2011
- Boele-Woelki Katharina , Sverdrup Tone, *European Challenges in Contemporary Family Law*, Intersentia, 2008
- Buck Trevor, *International Child Law*, Third edition, London & New York, Routledge, 2014

- Balili Arta Mandro, Meçaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana, E drejta familijare, Tiranë, 2006
- Дејан Донеv, Александра Деаноска- Трендафилова, Владимир Чадиковски, Петар Атанасов, Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Маја Парнарџиева- Змејкова, Елена Игновска. “Актуелните биоетички предизвици во Македонија”. Скопје, 2013.
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов. Семејно право, Скопје: Стоби Трејд, 2015.
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Елена Игновска, Новите репродуктивни технологии и правото, Скопје, 2016
- Dejan Mickovik, Aleksandra Deanoska,, Surrogacy in the West: Giving Birth in the Shadaow of the Law, Lambert Academic Publishing, 2017
- De Cruz Peter, Comparative Healthcare Law, Prinston, 2001
- David K. Gardner, Botros R. M. B. Rizk, Tommaso Falcone, Human Assisted Reproductive Technology: Future Trends in Laboratory and Clinical Practice, Cambridge University Press, 2011
- Davis, D. S., Genetic Dilemmas Reproductive Technology, Parental Choices, and Children’s Futures, Oxford University Press, 2010.
- Deech, R. and Smajdor, A., From IVF to Immortality, Controversy in the Era of Reproductive Technology, Oxford University Press 2007.
- Елена Игновска, “Биорепродуктивна етика и право. Новите репродуктивни технологии и родителското право”. Скопје, 2010.
- Elena Ignovska, Sperm Donation, Single Women and Filiation, Intersentia, 2015
- Emily Jackson, Medical Law: Text, Cases, and Materials, Oxford University Press, 2016
- Emily Jackson Regulating Reproduction - Law, Technology and Autonomy, Oxford - Portland, Oregon, 2001.
- Ellen L.K. Toronto, Joann Ponder, Kristin Davisson, Maurine Kelber Kelly (eds.), A Womb of Her Own: Women’s Struggle for Sexual and Reproductive Autonomy, Routledge, 2018
- Helen L. Conway, Family Law, London, 2006
- John R. Spencer, Antje Du Bois-Pedain, Freedom And Responsibility in Reproductive Choice, Hart Publishing, 2006
- Janice Raymond, Women as Wombs: Reproductive Technologies and the Battle Over Women's Freedom, Spinifex Press, 1994
- Marie Thérèse Meulders-Klein, Ruth Deech, Paul Vlaardingerbroek, Biomedicine, the Family, and Human Rights, Martinus Nijhoff Publishers, 2001
- Mickoviq Dejan, Ristov Angel, Zakon za semejstvoto, Skopje, Stobi Trejd, 2015

- Micković Dejan, Semejstvoto vo Evropa XVI-XXI vek Skopje, Blesok, 2008
- McGlynn Clare, Families and the European Union: Law, Politics and Pluralism, Cambridge University Press, 2006
- N. Bodiroga-Vukobrat, N. Hlača, D. Hrabar, D. Jakovac-Lozić, A. Korać Graovac, D. Lapaš, I. Majstorović, I. Medić Musa, B. Novak, H. Sikirić, V. Smokvina, S. Winkler, V. Žnidaršič Skubic, M. Župan, Europsko obiteljsko pravo, Narodne Novine, Zagreb, 2013
- Parkinson Patrick. Family Law and the Indissolubility of Parenthood, Cambridge, Cambridge University Press, 2011
- Ruth Deech and Anna Smajdor, From IVF to Immortality: Controversy in the Era of Reproductive Technology, Oxford University Press, 2007
- Rosamund Scott, Choosing Between Possible Lives Law and Ethics of Prenatal and Preimplantation Genetic Diagnosis, Oxford and Portland, Oregon, 2007.
- Rešetar, B., Aras Kramar, S., Lucić, N., Medić, I., Šago, D., Tucak, I. I Mioč, P. Suvremeno obiteljsko pravo i postupak, Pravni fakultet, Osijek, 2017
- Sherpe Jens Martin. European Family Law - Volume II, The Changing Concept of Family and Challenges for Domestic Family Law. Cheltenham, UK: Edward Elgar, 2016
- Jonada Zyberaj, Bioetika - përcaktimi i atësisë në zbatimin e teknikave të riprodhimit artificial heterolog, Tiranë, Universiteti i Tiranës, 2016

ARTIKUJ

- Arta Selmani- Bakiu, Emine Zendeli, Право на детето да го знае своето потекло. In Proceedings of the 3-rd International Scientific Conference- Ohrid School of Law. Effective Protection of the Human Rights and Liberties. Reality or Idea, pp. 231 – 250. [http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20\(1\)%20\(1\).pdf](http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20(1)%20(1).pdf)
- Игновска Е, 'Правно-етичките дилеми за новите репродуктивни технологии како начин на настанување на семејството' (25.10.2015), (Превземено од) <http://www.akademik.mk/>
- Игновска Е, 'Правото на детето да го знае генетското потекло' (20.10.2016) (Превземено од) <http://www.akademik.mk/>
- Arta Selmani, Стекнување на родителското право преку сурогат мајка- посебен осврт на Законот за изменување и дополнување на законот за биомедицинско потпомогнато оплодување (Proceeding of the Third International scientific conference Social change in the global world- Center for Legal and Political Research, Faculty of Law, Goce Delcev University, Shtip, Republic of Macedonia) p.129-152 , 2016
- Abraham Benschushan & Joseph G.Schenker, The right to an heir in the era of assisted reproduction, Human Reproduction vol.13 no.5 p.1407–1410, 1998

- Chaves M. Homoeffective Parentage in Relation to Medically Assisted Reproduction: a Paralel between Brazil and Portugal. U B. Atkin (ed.) The nternational Survey of Family Law (Bristol: Jordan Publishing Limited), 2011
- Curry-Sumner I., M. Vonk, National and International Surrogacy: An Odyssey. U B. Atkin (ed.) The International Survey of Family Law (Bristol: Jordan Publishing Limited), 2011
- Curry-Sumner I., M. Vonk, National and International Surrogacy: Something Old, Something New, Something International and Something Asked. U B. Atkin (ed.) The International Survey of Family Law (Bristol: Jordan Publishing Limited), 2012
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов, Биомедицински потпомогнато оплодување во Република Македонија, во Актуелните биоетички предизвици во Македонија, Ламина, Скопје, 2013.
- Дејан Мицковиќ, Договорите за сурогат мајчинство: етички и правни аспекти, Копачичка школа природног права, Правни живот, 2008.
- Дејан Мицковиќ, Дилеми во врска со законот за биомедицински потпомогнато оплодување, Правник, Скопје, март 2009.
- Дејан Мицковиќ, Постхумната репродукција и наследното право, Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, Vol. 61, Br. 2, Zagreb, 2011.
- Дејан Мицковиќ, Правните и етичките дилеми што произлегуваат од Законот за биомедицински потпомогнато оплодување на Република Македонија, Зборник од Првата меѓународна интердисциплинарна конференција „Биоетика-знак на новото доба: Биоетиката, медиумите, правото и медицината, Универзитет „Св. Кирил и Методиј“, Правен факултет На„Јустинијан Први,„ Скопје, 2012.
- Dejan Mickovik, Katerna Kockovska, Biomedically assisted fertilization in Macedonia and Slovenia, Iustinianus Primus Law Review, No. 6, 2013.
- Dejan Mickovik, Osnovne eticke i pravne dileme prilikom regulisanja medicinski potpomognute oplodnje u evropskim zakonodavstvima, Harmonius br. 2, Beograd, 2014.
- Дејан Мицковиќ, Сурогат мајчинството во Република Македонија, Охридска правна школа, „Новите предизвици во уредувањето на правните односи во духот на Европските вредности“, Juridica, Journal of Legal and Social Studies, Скопје, 2015.
- Дејан Мицковиќ, Статусот на ембрионот во современите законодавства, Iuridica Prima, Institute for Legal – Economic Research and Education, International Scientific Conference, Ohrid School of Law, No. 2016.
- Dejan Mickovik, Regulisanje surogat materinstva u savremenim zakonodavstvima, Zbornik radova “Nacionalno i меѓународно право-aktuelna pitanja i dileme”, Tom I, Univerzitet u Prištini sa privremenim sedištem u Kosovskoj Mitrovici, Kosovska Mitrovica 2017.

- Дејан Маролов, Елена Иванова. Етичките аспекти на сурогатството наспроти ставовите на законската регулатива. Годишен зборник на Правен факултет, 2015
- Dejan Mickovic, Angel Ristov. "Biomedical assisted fertilization in Macedonia, Serbia and Croatia: Ethical and legal aspects.
- Гордана Ковачек Станић, Породичноправни аспект биомедицински потпомогнутог оплођења у праву Србије и европским правима, Зборник матице српске за друштвене науке, свеска 131, 2010.
- Маролов Дејан, Максимова Елена. Етичките аспекти на сурогатството наспроти ставовите на законската регулатива.
- Олга Цвејић Јанчић, Зачеће уз помоћ медицине и права детета, Анали Правног факултета у Београду, бр. 2-3, 1992
- Roberts, J., Commerce & Regulation in the Assisted Reproduction Industry, Texas Law Review, Vol. 85, 2007.
- Schenner, J, G., Assisted Reproduction Practice in Europe: Legal and Ethical Aspects, Human Reproduction Update, Vol. 3, No. 2, 1997

LIGJET DHE DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE

- Additional Protocol to the Convention for the Protection of Human Rights and Dignity of the Human Being with regard to the Application of Biology and Medicine, on the Prohibition of Cloning Human Beings (1998). <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/168>
- Convention on the Rights of the Child, (1989). <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>
- Convention for the Protection of Human Rights and Dignity of the Human Being with regard to the Application of Biology and Medicine: Convention on Human Rights and Biomedicine (1997), <https://rm.coe.int/168007cf98>
- Directive 2004/23/EC of the European Parliament and of the Council of 31 march 2004 on setting standards of quality and safety for the donation, procurement, testing, processing, preservation, storage and distribution of human tissues and cells.(2004) <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:102:0048:0058:en:PDF>
- Directive 2006/86/EC of 24 October 2006 implementing Directive 2004/23/EC of the European Parliament and of the Council as regards traceability requirements, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32006L0086>
- "Ligji për ndryshime dhe plotësime të ligjit për mbarësim të ndihmuar biomedicinal" Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.149/2014
- Ligji për inseminim të ndihmuar biomedicinal, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.37/2008

- Ligji për familje i vitit 1998
- The Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women, 3.09.1981, <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw.htm>
- The European Convention on Human Rights, 4.11.1950, http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf

BURIME NGA INTERNETI

- Addendum to the Replies to questionnaire on access to medically assisted procreation (MAP), on right to know about their origin for children born after MAP \
- European Court of Human Rights, Case Law/ data base (Article 8) [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"sort":\["kpdata%20Descending"\],"kpthesaurus":\["425","429"\],"documentcollectionid2":\["DECISIONS"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)
- Human Rights in the Biomedical Field, www.coe.int/bioethics
- Medically assisted procreation and the protection of the human embryo comparative study on the situation in 39 states, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016803113ec>
- Replies by the member States to the questionnaire on access to medically assisted procreation (MAP), on the right to know about their origin for children born after MAP and on surrogacy, <https://rm.coe.int/inf-2016-4-map-replies-e/1680939b71>
- Replies by the member States to the questionnaire on access to medically assisted procreation (MAP) and on right to know about their origin for children born after MAP <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016803113e9>
- Recommendations.Resolutions.Reports. Questionnaires Compendium of texts of the Council of Europe on Bioethical Matters, https://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/texts_and_documents/
- The Protection of the Human Embryo In Vitro, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016803113e6>
- <https://www.coe.int/en/web/bioethics/embryo>
- [http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20\(1\)%20\(1\).pdf](http://www.iuridicaprima.mk/content/files/TOM%205%20finalno%20(1)%20(1).pdf)